



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 38 regjistër (JR)
Datë 18.09.2020

Nr. 40 i vendimit
Datë 27.10.2022

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Mimoza Tasi	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 27.10.2022, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 38/2020 (JR), datë 18.09.2020, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Skënder Haluci, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 244, datë 05.03.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Skënder Haluci.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni F i Aneksit të Kushtetutës; nenet 62, 63 dhe vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 47, 51, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkesave të subjektit të rivlerësimit të ngritura dhe në parashtrimet e dorëzuara në Kolegjin, i cili kërkoi përfundimisht prishjen e vendimit nr. 244, datë 05.03.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe urdhërimin e këtij të fundit për vazhdimin e hetimit administrativ për të tre komponentët e procesit të rivlerësimit që lidhen me pasurinë, figurën dhe aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit Skënder Haluci, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Skënder Haluci ka ushtruar detyrën e gjyqtarit që prej vitit 1996¹ dhe, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, brenda afatit ligjor², në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë³ deklaratën për kontrollin e figurës⁴ dhe formularin për vetëvlerësimin profesional⁵.
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) *Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin.*
 - (ii) *Nuk ka dokumentacion të plotë për burimet financiare për të justifikuar pasuritë.*
 - (iii) *Nuk ka fshehje të pasurive.*
 - (iv) *Nuk ka kryer deklaram të rremë.*
 - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

¹ Subjekti ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në periudhat shkurt 1996 - maj 1999 (gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë) dhe nëntor 2011 deri në shkarkimin e tij me vendimin objekt ankimi (gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë).

² Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

³ Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 27.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 27.01.2017. Të njëjtën datë mban dhe deklaratat e pasurisë në rubrikën përkatëse.

⁴ Referuar paragrafit 9 të vendimit të Komisionit.

⁵ Referuar paragrafit 10 të vendimit të Komisionit.

4. Referuar paragrafit 9 në faqet 2 dhe 3 të vendimit të Komisionit: *DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, me shkresën nr. {***} prot., datë 26.12.2018 (deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 8.1.2019, të KDZh-së) në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.*
5. Referuar paragrafit 10 në faqen 3 të vendimit të Komisionit: *Inspektorati i KLD-së ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.*
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (sikundër shprehet në vendimin e tij nr. 244, datë 05.03.2020⁶), kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Skënder Haluci, bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke marrë vendimin nr. 244, datë 05.03.2020.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 244, datë 05.03.2020, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Skënder Haluci, me funksion gjyqtar/kryetar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.

Në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në njërën prej kriterëve të vlerësimit, atë të pasurisë, në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat e administruara nga Komisioni, në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, z. Skënder Haluci:

- (i) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 1997-2016;*
- (ii) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për të ardhurat;*
- (iii) ka bërë deklaram të pasaktë dhe të rremë lidhur me pasuritë e krijuara dhe burimin e ligjshëm;*
- (iv) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016;*
- (v) nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij dhe të personave të lidhur në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*

⁶ Shih paragrafët 9 dhe 10, faqe 2 dhe 3 të vendimit të Komisionit nr. 244, datë 05.03.2020.

III. Shkaqet e ankimit

9. Subjekti i rivlerësimit iu drejtua Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 244, datë 05.03.2020, me pretendimin se vendimi është rezultat i zbatimit të gabuar të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, si dhe të akteve normuese të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Sipas subjektit të rivlerësimit, vendimi objekt ankimi është rezultat i një procesi të paragjykuar dhe rrjedhojë e mosanalizimit të provave të dorëzuara prej tij.
10. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me ankimin, ka depozituar edhe kërkesën drejtuar Komisionit më datë 03.03.2020, me objekt “Marrja e provave të reja, si dhe riçelja e hetimit administrativ dhe vlerësimi për të tria kriteret, ashtu siç parashikon ligji dhe Kushtetuta”, si dhe shpjegimet e dorëzuara në Komision “Në lidhje me rezultatin e hetimit administrativ të KPK-së, për subjektin Skënder Haluci”. Bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a”, 63, pika 1, 65, 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, nenet 47, 51, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit Skënder Haluci kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:
- *Kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative me nr. 244 vendimi, datë 05.03.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në lidhje me subjektin e rivlerësimit Skënder Haluci.*
 - *Vazhdimin e hetimit administrativ edhe për tre komponentët e procesit të rivlerësimit që lidhen me pasurinë, figurën dhe aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit Skënder Haluci.*
 - *Ndryshimin e vendimit nr. 244, datë 05.03.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Skënder Haluci, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.*
11. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale, si dhe ato të zbatimit të ligjit material, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.
- 11.1. *Subjektit të rivlerësimit i është njoftuar vendimi i Komisionit në shkelje flagrante të rregullave të njoftimit duke i cenuar të drejtën për një mbrojtje efektive, si dhe për të paraqitur ankim brenda një afati të arsyeshëm.*
- 11.2. *Vendimi i Komisionit nr. 244, datë 05.03.2020, është marrë bazuar në fakte të pavërteta që nuk i përgjigjen realitetit dhe provave që janë paraqitur, të cilat, sipas subjektit të rivlerësimit, provojnë bindshëm dhe pa mëdyshje fakte që janë mohuar apo keqinterpretuar në vendim. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka kryer një hetim shumë të cekët dhe të orientuar nga qëllimi për të përfunduar sa më parë procesin, me përfundimin e paracaktuar për shkarkimin e tij nga detyra.*

11.3. Komisioni ka cenuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për proces të rregullt ligjor, në drejtim të mosrespektimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, për sa kohë i njëjti komision që ka bërë hetimin administrativ, analizimin e provave, i njëjti komision ka dhënë edhe vendimin përfundimtar në rolin e gjyqtarit.

11.4. Komisioni ka shkelur të drejtën e subjektit për proces të rregullt ligjor, në kuptim të parashikimeve të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”), duke qenë se vendimmarrja e Komisionit e bazuar në një kriter, atë të pasurisë, është paragjyquese dhe tërësisht në kundërshtim me nenin Ç të Aneksit të Kushtetutës, sipas të cilit vlerësimi bëhet bazuar në 3 kriteret.

11.5. Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e dyfishit të pasurisë së ligjshme. Komisioni ka vendosur në kundërshtim edhe me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur kjo dispozitë ligjore kërkon plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të dy kritereve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë.

11.6. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se kjo çështje duhet kaluar për gjykim në seancë gjyqësore publike, pasi, sipas tij, debati gjyqësor është i nevojshëm: (i) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, për efekt të së cilës, sipas subjektit, është e nevojshme të provohen fakte të reja dhe të merren prova të reja; (ii) për shkak se Komisioni ka lejuar shkelje të rënda procedurale sepse është treguar i njëanshëm dhe e ka paragjykuar çështjen duke rrëzuar çdo kërkesë të ankuesit.

12. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

12.1. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament papafingo, me sip. 242 m²”, në katin e tretë të një ndërtese në rrugën “{***}”, Tiranë, në proces legalizimi:

i. Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe se është në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie me burime të ligjshme, është konkluzion i njëanshëm dhe në tejkallim të kompetencave që ligji i jep Komisionit.

ii. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka tejkalluar kompetencat duke kërkuar ligjshmërinë e burimit të pasurive të vëllezërve të tij, të cilësuar si persona të tjerë të lidhur, duke shkelur në këtë mënyrë ligjin dhe praktikën e Kolegjit.

12.2. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “tokë arë”, me sipërfaqe 1400 m², me nr. pasurie {***}, ZK nr. {***}, me vendndodhje në Sauk, Tiranë, fituar me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.01.2015, përpara noterit publik Y.C.:

- iii. *Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit lidhur me krijimin e kësaj pasurie si të arritur në shtrembërim të fakteve dhe provave të vëna në dispozicion nga ana e tij, në drejtim të vitit të krijimit të pasurisë dhe vlerës së shpenzuar për blerjen e saj.*
- iv. *Subjekti kundërshtoi si të gabuar dhe pa mbështetje ligjore dhe faktike konkluzionin e Komisionit se, duke mos përcaktuar në kontratë vlerën e saktë të blerjes së kësaj pasurie, duket se janë shmangur edhe detyrimet përkatëse në buxhetin e shtetit (duket se është kryer evazion fiskal me deklarimin e vlerës së shitblerjes prej 140.000 lekësh, të kësaj pasurie dhe jo të vlerës reale).*
- v. *Subjekti kundërshtoi si të pabazuar edhe konkluzionin për pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2015, referuar analizës financiare për këtë vit, me pretendimin se kjo pasuri është blerë në vitin 1997 dhe jo në vitin 2015, vit ky në të cilin është formalizuar akti i shitjes dhe është bërë pagesa e vetëm 1/10-tës pjesë të çmimit të shitblerjes.*

12.3. Lidhur me pasurinë e paluajtshme “tokë arë”, me sip. 890 m², të blerë nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në vitin 1999:

- vi. *Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratën para fillimit të detyrës, shitjen e saj dhe të ardhurat e krijuara nga ky transaksion në deklaratën periodike të vitit 2004 dhe atë të pasurisë vetting, me pretendimin se nuk ka pasur një detyrim të tillë ligjor.*
- vii. *Subjekti kundërshtoi si të gabuar edhe analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 1999 kur është kryer blerja e kësaj pasurie.*

12.4. Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit automjet, të tipit “Mercedes Benz”, vit prodhimi 2000, me targa {***}, të blerë në vitin 2013, në vlerën e 400.000 lekëve:

- viii. *Subjekti kundërshtoi si të padrejtë analizën financiare të kryer nga Komisioni lidhur me krijimin e kësaj pasurie, me pretendimin se: (i) janë vlerësuar në mënyrë të padrejtë të ardhurat nga bursa e vajzës së tij, të cilat, sipas subjektit, përfshinin edhe shpenzimet e jetesës dhe akomodimit, të cilat Komisioni ia ka përllogaritur veçmas; (ii) nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e bashkëshortes së tij nga puna në Dhomën Kombëtare të Zgjidhjes së Konfliktëve pranë F. Sh. F.; (iii) nuk janë marrë në konsideratë gjendjet e likuiditetit “cash” të deklaruar në vitin paraardhës; si dhe (iv) në mënyrë të gabuar, analiza për këtë mjet është kryer në datën e blerjes së automjetit dhe jo në fund të vitit.*

12.5. Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit automjet, të tipit “Jaguar X Type”, vit prodhimi 2004, të blerë në vitin 2015, në vlerën totale të deklaruar prej 450.000 lekësh (përfshirë detyrimin doganor):

- ix. *Subjekti pretendoi se Komisioni në trajtimin e kësaj pasurie, ka shtrembëruar faktet. Sipas subjektit të rivlerësimit, ai në asnjë rast nuk ka pretenduar të ketë qenë personalisht në Angli,*

në momentin e nënshkrimit të kontratës për blerjen e automjetit. Sipas subjektit të rivlerësimit, legjislacioni anglez e njuh të drejtën e regjistrimit të mjetit në emër të blerësit edhe pa qenë blerësi prezent. Subjekti pretendon gjithashtu se Komisioni qëllimisht i ka llogaritur një pjesë shpenzimesh për shkollimin e vajzës në ShBA, në vlerën e 450.000 lekëve, për 9 muaj në vitin 2015, ndërkohë që sipas tij, bursa e vajzës përfshinte të gjitha shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit.

12.6. Lidhur me llogaritë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit:

- x. Subjekti pretendoi se referuar parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, ai nuk ka pasur asnjëherë detyrimin të deklarojë nëpër deklaratat periodike vjetore gjendjet e llogarive bankare të bashkëshortes së tij dhe se ka menduar që formulari në çdo rast është plotësuar në mënyrë të rregullt nga ana e saj.*

12.7. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament”, me sip. 106 m², me nr. pasurie {*}, ZK {***}, rruga “{***}”, pall. {***}, shk. {***}, Tiranë, blerë në vitin 2003 në vlerën e 1.600.000 lekëve:**

- xi. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit për çmim favorizues në blerjen e apartamentit me pretendimin se kjo gjë ka ndodhur si pasojë e faktit që shitësi i kësaj pasurie është njëkohësisht edhe blerësi i pasurisë së paluajtshme të llojit “dyqan” në rr. “{***}”, Tiranë, në pronësi të subjektit të rivlerësimit.*
- xii. Subjekti kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit për pamundësi financiare në krijimin e kësaj pasurie, me pretendimin se në analizën financiare të Komisionit, janë përfshirë gabimisht shpenzime që nuk i takojnë subjektit të rivlerësimit, si dhe nuk janë përfshirë disa zëra të ardhurash.*

12.8. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament” me sip. 65m², me adresë në rrugën “{*}”, Tiranë, blerë me kontratë sipërmarrjeje në vitin 2000, në vlerën e 3.000.000 lekëve:**

- xiii. Në lidhje me konkluzionin e Komisionit për deklarim të pasaktë lidhur me vlerën e blerjes së kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit pretendoi se diferenca në vlera e konstatuar nga ana e Komisionit, është e drejtë dhe ka ardhur si rrjedhojë e faktit se në vitin 2004, deklarimi i vlerës së apartamentit është bërë me përafërsi bazuar në deklaratimet e bashkëshortes pasi ai nuk e ka pasur në dispozicion kontratën e sipërmarrjes. Ndërsa në deklaratën e pasurisë “vetting”, subjekti i rivlerësimit pretendon se deklarimi është kryer nga bashkëshortja, bazuar në përmbajtjen e kontratës.*
- xiv. Subjekti kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me veprimet e kryera dhe destinacionin e kredisë së marrë në vitin 2004 pranë Bankës Intesa San Paolo dhe pretendoi se destinacioni i saj ka qenë pikërisht shlyerja e pjesës së mbetur të vlerës së këtij apartamenti, pasi 1.000.000 lekë ishin shlyer nga bashkëshortja në momentin e lidhjes së kontratës dhe pjesa tjetër sipas vërtetimit të lëshuar nga shoqëria “{***}” ShPK.*

- xv. *Subjekti ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit për shmangien e pagimit të detyrimeve tatimore si pasojë e mosregjistrimit të pasurisë në ZVRPP, si konkluzion të pabazuar, duke pretenduar që regjistrimi i kësaj pasurie nuk është realizuar si pasojë e mosregjistrimit të objektit nga firma ndërtuese dhe jo për faj të subjektit të rivlerësimit.*
- xvi. *Subjekti kundërshtoi edhe analizën financiare të kryer nga Komisioni lidhur me verifikimin e mundësisë financiare për krijimin e kësaj pasurie dhe pretendoi se përlllogaritjet e Komisionit nuk janë bërë në mënyrë korrekte, pasi nuk janë përlllogaritur të ardhurat, nuk janë marrë në konsideratë kreditë, si dhe dokumentacioni i paraqitur nga bankat dhe firmat ndërtuese. Subjekti kundërshtoi edhe vlerën e përlllogaritur si shpenzime për shkollimin e vajzës me të njëjtin argument si më sipër, se bursa përfshinte edhe kostot e jetesës dhe akomodimit.*
- xvii. *Subjekti kundërshtoi si të padrejtë konkluzionin e Komisionit se dokumentacioni i depozituar në lidhje me financimin e bursës së përfutur nga vajza e subjektit të rivlerësimit për shkollim në {***} në vitet 2014-2017, në vlerën e 181.478 USD, si dhe bursës për shkollim në {***}, Mostar, në vitet 2012-2014, në vlerën prej 30.000 eurosh, është i paplotë, me pretendimin se në bursat e akorduara përfshihen edhe shpenzimet për ushqim dhe akomodim dhe ky fakt mund të provohet lehtësisht me një shkresë drejtuar këtyre institucioneve arsimore.*

12.9. Lidhur me konkluzionin e Komisionit mbi çështjen e shpenzimeve të vajzës së subjektit të rivlerësimit për shkollën verore në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2012, subjekti shprehet se ky shpenzim nuk është deklaruar prej tij në deklaratën periodike dhe as në deklaratën e pasurisë vetting për shkak se këto shpenzime janë përballuar nga ana e tij dhe e bashkëshortes së tij dhe se të paguara veç e veç nuk e kalonin limitin e 300.000 lekëve për deklaram. Subjekti sqaroi se edhe në pyetësor nuk e ka deklaruar vlerën e plotë, pasi nuk e dispononte dokumentacionin e saktë.

12.10. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “bar-kafe”, me sip. 65 m², me adresë në rrugën “{***}”, Tiranë:

- xviii. *Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar analizën financiare të kryer nga Komisioni lidhur me pamundësinë financiare për krijimin me burime të ligjshme të kësaj pasurie në vitin 1998, me pretendimin se në këtë analizë Komisioni ka përfshirë në mënyrë të padrejtë: (i) shlyerjen e kredisë tek UBA Bank, në masën e 4.705.190 lekëve, si shpenzim të kryer nga subjekti i rivlerësimit, ndërkohë që sipas subjektit të rivlerësimit, ky veprim bankar është kryer nga z. F. V. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit referon ekstraktin e llogarisë së kredisë të lëshuar në datën 07.02.2020, si dhe një deklaratë noteriale të z. F. V., i cili konfirmon këtë marrëdhënie mes tij dhe subjektit të rivlerësimit; (ii) shumën prej 60.000 eurosh si shpenzim për likuidimin e lokalit, ndërkohë që ky likuidim është bërë me kredinë e marrë në vitin 2002, ndërsa vetë kredia është likuiduar në vitin 2003, pjesërisht nga të ardhurat e lokalit dhe pjesa e mbetur nga blerësi F. V.; (iii) vlerën prej 2.319.523 lekësh, si shpenzim për ndërtim shtëpie në rrugën “{***}”, ndërkohë që sipas subjektit të rivlerësimit, e gjithë vlera e shpenzuar për ndërtimin e kësaj shtëpie, nuk e kalon vlerën e 2.000.000 lekëve.*

12.11. Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit automjet, të tipit “Mercedes Benz”, të blerë në vitin 2012, në vlerën e 200.000 lekëve dhe shitur në vijim vëllait të subjektit të rivlerësimit, në vlerën e 500.000 lekëve:

xix. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi analizën e kryer nga Komisioni lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme për krijimin e këtij automjeti, në drejtim të mosmarrjes në konsideratë të gjendjes “cash” të vitit paraardhës, të ardhurave të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga F. Sh. F., si dhe të faktit se shpenzimet për automjetin janë kryer deri në datën e shitjes së automjetit dhe jo në momentin e blerjes së tij, sikundër i ka përllogaritur Komisioni.

12.12. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga marrëdhëniet e punës, sipas deklaramit në deklaratën e pasurisë *vetting*:

xx. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit lidhur me mosmarrjen në konsideratë të të ardhurave të bashkëshortes së tij nga marrëdhëniet e punësimit sipas vlerës së tyre në vërtetimet përkatëse të punëdhënësve, si qëndrim me dy standarde dhe cenim të parimit të barazisë, duke qenë se në raste të tjera, për të tjera subjekte rivlerësi, Komisioni ka mbajtur qëndrim të ndryshëm.

12.13. Lidhur me rezultatin e analizës financiare:

xxi. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi rezultatin e analizës financiare si analizë arbitrare, duke evidentuar se: (i) kostoja reale e tokës dhe e banesës së ndërtuar në të, nga 3.400.000 lekë, është llogaritur në 20.875.706 lekë banesa dhe 37.945.600 lekë toka, gjithsej mbi 58.000.000 lekë janë llogaritur si shpenzime të subjektit të rivlerësimit; (ii) shlyerja e kredisë në vlerën e 34.965 USD, është kryer nga z. F. V. dhe jo nga subjekti; si dhe se (iii) nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga marrëdhëniet e saj të punësimit, të cilat, sipas subjektit të rivlerësimit, kapin vlerën e mbi 20.000.000 lekëve.

13. Në datën 13.10.2022, pas njoftimit të marrë për caktimin e datës së gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit dorëzoi pranë Kolegjit një material shkresor, të titulluar "Parashtresa", dhe bashkëlidhur tij ka dorëzuar edhe dy akte shkresore, konkretisht: 1. raport vlerësi pasurie të paluajtshme, i datës 01.06.2022, me vlerësues ing. Sh. A. dhe P. K.; dhe 2. certifikatë sigurie të kategorisë "C", tepër sekret, të lëshuar nga DSIK-ja më datë 31.03.2011, për të cilat ka kërkuar administrimin e tyre si prova të reja në proces.

IV. Vlerësi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

14. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Skënder Haluci, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në

juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i ankuesit*

15. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁷ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

16. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 244, datë 05.03.2020, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
17. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit për çelje të hetimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

17.1. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se çështja e tij duhej gjykuar në seancë gjyqësore publike, pasi sipas tij, debati gjyqësor është i nevojshëm për shkak se:

- a) Konstatimi i gjendjes faktike nga Komisioni nuk është bërë në mënyrë të plotë dhe të saktë. Për këtë arsye, sipas subjektit të rivlerësimit, është e nevojshme të provohen fakte të reja dhe të merren prova të reja. Në kuadër të kësaj kërkesë, subjekti i rivlerësimit pretendoi se pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova sepse vetë Komisioni ia ka rrëzuar kërkesën për riçelje të hetimit për vlerësimin edhe të dy kriterëve të tjera, atij të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, të cilat, sipas subjektit, përbëjnë prova të reja, të cilat i disponon vetëm Komisioni. Subjekti pretendoi se nuk ka dijeni për këto raporte dhe se ato nuk i janë nënshtruar debatit në seancën dëgjimore në Komision, megjithëse sipas tij, në vendimin e Komisionit citohet raporti i DSIK-së, që thotë se subjekti është i papërshtatshëm për ushtrimin e funksionit. Sipas subjektit të rivlerësimit, në kushtet kur vlerësimi i Komisionit është kryer bazuar vetëm në kriterin e pasurisë, duke rrëzuar çdo kërkesë të subjektit të rivlerësimit, faktet e reja që duhet të merren nga Kolegji, janë faktet dhe provat që lidhen me vlerësimin e figurës dhe aftësive profesionale. Gjithashtu, subjekti i referohet këtu edhe kërkesës së tij për marrje të provës me dëshmitarë, e cila sipas tij është rrëzuar nga Komisioni dhe kërkohet të merret si provë e re nga Kolegji.

⁷ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 244, datë 05.03.2020, për rivlerësimin e subjektit Skënder Haluci, i është njoftuar këtij të fundit me shkresën nr. {***} prot., datë 03.08.2020, konfirmuar marrja dijeni nga subjekti i rivlerësimit më datë 04.08.2020, sipas lajmërimarrjes së shërbimit postar (ndonëse subjekti ngre pretendime lidhur me njoftimin e vendimit dhe, rrjedhimisht, dhe konfirmimin e tij). Kurse ankimi i subjektit rezultoi të jetë depozituar në Komision në datën 19.08.2020, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit, nr. {***}, datë 19.08.2020, që rezultoi të jetë dita e 15 nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit.

b) Komisioni ka lejuar shkelje të rënda procedurale sepse është treguar i njëanshëm dhe e ka paragjykuar çështjen duke rrëzuar çdo kërkesë të ankuesit. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka rrëzuar tri kërkesa të tij: (1) kërkesën për shtyrjen e afatit për dorëzimin e provave, duke i caktuar atij seancën dëgjimore pa prituri për të shqyrtuar provat që do të vinin nga ShBA; (2) kërkesën për riçeljen e hetimit edhe për dy kriteret e tjera; si dhe (3) kërkesën për thirrjen e dëshmitarëve. Në kuadër të sa më sipër, subjekti, në mbështetje të shkakut të ankimit për njëanshmëri të Komisionit dhe vendimmarrje të paracaktuar prej tij, shprehet se sa më sipër provohet nga fakti se në seancën dëgjimore të datës 03.03.2020, lidhur me kërkesën me shkrim për marrjen e provave të reja, Komisioni ka vendosur pranimin e kërkesës, por ndërkohë provën me dëshmitarë, si dhe këqyrjen në vend të objektit apartament banimi në rrugën “{***}” nuk rezultoi t’i ketë marrë dhe, sipas tij, ky fakt nuk përmendet as në vendimin e arsyetuar të Komisionit. Kjo situatë, sipas subjektit të rivlerësimit, përbën shtrembërim të fakteve dhe rrethanave të çështjes dhe, për rrjedhojë, përbën shkak për procedim disiplinor të trupës gjyquese të Komisionit. Në këtë kontekst, subjekti i rivlerësimit, duke iu referuar parashikimeve të neneve 16 dhe 17 të ligjit nr. 84/2016, shprehet se është në kompetencën e Kolegjit edhe fillimi i procedimit disiplinor ndaj anëtarëve të Komisionit.

18. Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit të parashtruar në ankimin e tij dhe të pasqyruar në mënyrë të hollësishme në paragrafin 17.1 më sipër, trupi gjyqësor vlerësoi se kjo kërkesë nuk gjen mbështetje ligjore dhe, për rrjedhojë, nuk mund të justifikojë kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike në prezencë të palëve, për arsye të mëposhtme.

18.1. Në lidhje me pretendimin për moskonstatim të plotë dhe të saktë të situatës faktike duke iu referuar në këtë drejtim dy kriterëve të rivlerësimit, atij të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjyqësor vlerësoi se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk është i bazuar në fakte, për sa kohë vendimi i Komisionit është bazuar vetëm në njërin prej tri kriterëve të rivlerësimit dhe konkretisht kriterit të vlerësimit të pasurisë. Për rrjedhojë, çdo pretendim i subjektit të rivlerësimit në drejtim të konstatimit të gjendjes faktike, duhet të lidhet vetëm me kriterin e vlerësimit të pasurisë, i cili është vlerësuar nga Komisioni dhe jo për kriteret për të cilat Komisioni nuk ka arritur në konkluzione lidhur me vlerësimin e tyre. Në këtë kontekst, trupi gjyqësor çmoi se kërkesat për administrimin e raporteve të hartuara nga organet kompetente në kuadër të procedurës së rivlerësimit, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale dhe trajtimin e tyre si prova të reja në procesin e shqyrtimit të ankimit, duhet të rrëzohen, në kuptim të parashikimeve të nenit 49, pika 6, germa “a”, si prova të panevojshme në këtë proces.

18.2. Sa i takon konstatimit të subjektit të rivlerësimit se ai nuk ka dijeni për këto raporte dhe se ato nuk i janë nënshtruar debatit në seancën dëgjimore në Komision, megjithëse, sipas tij, në vendimin e Komisionit citohet raporti i DSIK-së që thotë se subjekti është i papërshtatshëm për ushtrimin e funksionit, trupi gjyqësor, pasi verifikoi aktet e fashikullit, konstatoi se procedura e hetimit administrativ të Komisionit lidhur me këto dy kriteret, sikundër u bë e ditur edhe nga paragrafët pararendës, nuk është përfunduar dhe, për rrjedhojë, aktet e administruara gjatë hetimit të këtyre dy kriterëve, nuk i janë nënshtruar diskutimit në seancën dëgjimore të mbajtur për subjektin e rivlerësimit në datat 02.03.2020 dhe 03.03.2020, e cila është përqendruar vetëm në gjetjet lidhur me kriterin e pasurisë. Pavarësisht kësaj, sikundër u shtjellua dhe më sipër në vendim, ky fakt nuk përbën shkak për cenim të vendimmarrjes së Komisionit, sa kohë ky i fundit është bazuar vetëm mbi rezultatet e hetimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë. Gjithashtu, nga verifikimi i kryer në aktet e fashikullit të Komisionit, rezultoi se pretendimi i subjektit, sipas të

cilit Komisioni është shprehur në vendim se DSIK-ja ka konstatuar papërshtatshmërinë e tij për ushtrimin e funksionit, është i pabazuar në fakte, pasi referuar përmbajtjes së vendimit të administruar në fashikullin e çështjes, në pjesën që citohet procedura e kryer nga DSIK-ja, cituar edhe në paragrafin 4 më sipër në vendim, nuk rezulton një fakt i tillë.

18.3. Në lidhje me pretendimet e ngritura në drejtim të shkeljeve procedurale të kryera nga Komisioni, si pasojë e mospranimit të kërkesave të subjektit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstatoi se:

a) Në datën 20.02.2020, trupi gjykues i Komisionit është shprehur me vendim, në të cilin vëren: *Në datën 18.02.2020, subjekti ka depozituar shpjegimet e tij me shkrim pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke kërkuar të administrohen prova të reja shkresore, të thirren persona në cilësinë e dëshmitarëve, si dhe të kërkohej kohë për paraqitje provash të reja. Kërkesa për thirrjen e dëshmitarëve është paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në datën 18.02.2020, brenda materialit “Shpjegimet në lidhje me rezultatit e hetimit administrativ të KPK-së, për subjektin Skënder Haluci”, lidhur me rezultatet e hetimit të datës 03.02.2020. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar shprehimisht: 1. Pyetjen e shtetasit I. I. Z. [...]. 2. Pyetjen e noterit A. R.. Afat shtesë lidhur me paraqitjen e dokumentacionit me vulë apostille, për përfitim të bursës së vajzës.*

b) Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, Komisioni rezultoi që për secilën prej kërkesave të subjektit të rivlerësimit, është shprehur dhe ka arsyetuar në drejtim të secilës prej tyre në kuadër të parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, Komisioni rezultoi të ketë vendosur: *1. Të pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për pranimin e të gjitha provave shkresore të paraqitura nga ana e tij, duke i administruar ato në përputhje me nenin 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. 2. Të refuzojë kërkesën për thirrjen si dëshmitarë të shtetasit I. I. Z.. 3. Të refuzojë kërkesën për thirrjen si dëshmitarë të noterit A. R.. 4. Të refuzojë kërkesën për afat shtesë lidhur me paraqitjen e dokumentacionit me vulë apostille, për përfitim të bursës së vajzës. [...]* Ky vendim i arsyetuar i është përcjellë subjektit të rivlerësimit nëpërmjet komunikimit me e-mail-in e datës 04.03.2020.

18.4. Në analizë të sa më sipër, vlerësuar kjo situatë faktike në kuadër të parashikimeve ligjore në fuqi, trupi gjykues arriti në përfundimin se Komisioni, në vlerësimin e kërkesave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, kryesisht sa u takon kërkesave për marrjen e provave, ka vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit refuzimi i kërkesës për marrjen e provës bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit, duke argumentuar shkaqet e refuzimit. Në këto kushte, nuk konstatohen nga ana e Komisionit shkelje të natyrës procedurale në lidhje me trajtimin e këtyre kërkesave të subjektit të rivlerësimit.

18.5. Sa u takon pretendimeve lidhur me kërkesën e depozituar nga subjekti i rivlerësimit para Komisionit, gjatë seancës dëgjimore të datës 02.03.2020, trupi gjykues konstatoi se në kërkesën e depozituar me shkrim nga subjekti i rivlerësimit, me objekt “Marrja e provave të reja, si dhe riçelja e hetimit administrativ dhe vlerësimi për të tria kriteret ashtu siç parashikon ligji dhe Kushtetuta”, subjekti, në përmbajtje të kërkesës, është shprehur: *Sa u përket konkluzioneve tuaja në lidhje me kriterin e pasurisë, po paraqes disa prova të reja të cilat e kam pasur të pamundur t’i paraqes më parë, si dhe po risjell në vëmendjen tuaj disa prova të cilat janë dërguar edhe më parë nga ana ime, të cilat, në gjykimin tim, e bëjnë të domosdoshme riçeljen e hetimit administrativ qoftë edhe vetëm për kriterin e pasurisë.* Në vijim, subjekti ka parashtruar sipas nevojës aktet e sjella në cilësinë e provave të reja, si dhe shpjegimet e tij në lidhje me disa çështje, si: të ardhurat e bashkëshortes, vlerësimin e pasurisë “apartament banimi në rrugën {***}”, vlerën e blerjes së tokës me sip. 1400 m², si dhe automjetin tip “Jaguar”.

18.6. Përgjatë kësaj parashtrëse, trupi gjykues konstatoi se sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit në drejtim të këqyrjes së apartamentit në rrugën “{***}” dhe thirrjes së banorëve përreth këtij apartamenti, në cilësinë e dëshmitarëve, subjekti është shprehur si vijon: *Në lidhje me pasurinë, 1 kat apartament banimi në rrugën “{***}”, ashtu siç ju kam bërë me dije edhe në parashtrimet e datës 18.02.2020, ku ju kam dërguar edhe një akt ekspertimi që përcakton vlerën e investimit për pjesën time takuese, nëse akoma nuk jeni të bindur në bazë të nenit 49, pika 7, mund të bëni këqyrjen në vend të objektit [...]. Sa i përket çmimit të blerjes së truallit në rrugën “{***}”, përveç shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të dërguar në lidhje me kontratat e ngjashme në atë zonë, si dhe deklaratën noteriale të shitësit, nëse këto nuk ju duken bindëse, atëherë kërkoj të pyeten si dëshmitarë të gjithë banorët e asaj zone kadastrale [...]. Subjekti e mbyll kërkesën e tij si vijon: *Së fundi, në konkluzion të gjithëcka kam parashtruar më sipër, të nderuar anëtarë të KPK-së, ripërsëris edhe një herë kërkesën time të paraqitur në fillim të këtyre parashtrimeve, në zbatim rigoroz të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 [...], kërkoj nga ana juaj riçeljen e hetimit administrativ duke zhvilluar procedurën e rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret, ashtu siç kërkon në mënyrë taksative ligji dhe Kushtetuta [...].**

18.7. Trupi gjykues i Komisionit, pasi e ka marrë këtë kërkesë në shqyrtim, është shprehur me vendimin nr. {***}, datë 02.03.2020, me anë të të cilit ka vendosur: (i) të administrojë provat e reja të depozituara nga ana e subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore; (ii) mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për riçeljen e hetimit dhe përfshirjen e dy komponentëve të tjerë deri në këtë fazë të hetimit administrativ.

18.8. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vlerësoi se Komisioni ka qenë i qartë në disponimin e tij se ka vendosur të administrojë në cilësinë e provave të reja aktet e depozituara nga ana e subjektit të rivlerësimit, çka nënkuptoi se nuk përfshinte në vendimmarrjen e tij provën me dëshmitarë dhe këqyrjen e objektit, për të cilat, referuar përmbajtjes së kërkesës së datës 02.03.2020, subjekti nuk rezultoi të ketë bërë kërkesë formale për marrjen e këtyre provave (në rastin e provës me dëshmitarë, subjekti nuk ka treguar as emrat e dëshmitarëve), por duket që këtë e ka lënë në vlerësimin diskrecional të Komisionit. Në këtë kuptim, vendimmarrja e Komisionit lidhur me sa më sipër, nuk vlerësohet nga trupi gjykues në kundërshtim me parashikimet e nenit 49 të ligjit nr. 84/2016.

18.9. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues e gjeti të pabazuar pretendimin e subjektit për shkelje procedurale në drejtim të mënyrës së trajtimit të kërkesave të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, referuar sa më sipër trajtuar, i pabazuar në fakte u gjet edhe pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit për shtrembërim të fakteve nga ana e Komisionit në vendimin objekt shqyrtimi. Në këto kushte, shkaku i ankimit i bazuar në pretendimet e mësipërme, gjendet i pabazuar në fakte.

19. Për rrjedhojë, trupi gjykues arriti në përfundimin që nuk përmbushen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike. Trupi gjykues arriti në këtë konkluzion edhe për faktin se aktet e dorëzuara në cilësinë e provave të reja, nuk përmbushin kriteret e parashikuara në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit nga Komisioni dhe çështje të zbatimit të legjislacionit

20. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se mënyra e njoftimit të vendimit të Komisionit është në shkelje flagrante të rregullave të njoftimit të subjekteve dhe ka cenuar të drejtën e tij për një mbrojtje efektive, si dhe për të paraqitur ankim brenda një afati të arsyeshëm. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se vendimi i është njoftuar në shkelje të parashikimeve të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, rreth 5 muaj jashtë afatit 30-ditor të përcaktuar në këtë dispozitë dhe se lidhur me vendimin e Komisionit, ka marrë dijeni më datë 14.08.2020, rreth orës 22:00, kohë në të cilën, sipas tij, vendimi i është dorëzuar bashkëshortes nga një kamerier i një lokali poshtë pallatit në të cilin banon subjekti, ndonëse ai shprehet se i ka vënë në dispozicion Komisionit jo vetëm adresën e banimit, por edhe adresën elektronike dhe numrin e telefonit. Subjekti pretendoi se nuk ka nënshkruar asnjë njoftim marrjeje lidhur me komunikimin që i është bërë vendimit nga ana e Komisionit.
21. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi procedurën e ndjekur nga Komisioni lidhur me njoftimin e vendimit subjektit të rivlerësimit, konstatoi si më poshtë.
- 21.1. Referuar materialeve të fashikullit gjyqësor, konstatohet se vendimi i Komisionit nr. 244, datë 05.03.2020, u është njoftuar palëve më datë 03.08.2020, në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në nenin 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, por nuk rezultoi i dokumentuar shkaku se përse vendimi i arsyetuar u është njoftuar palëve të përfshira në proces pas rreth 5 muajsh nga data e shpalljes së vendimit, ndonëse referuar faqes zyrtare të Komisionit, trupi gjykues konstatoi se më datë 12.03.2020, ky i fundit ka bërë një njoftim zyrtar, në përmbajtje të të cilit, në kuadër të përshkallëzimit të masave mbrojtëse ndaj COVID-19, ka njoftuar kufizimin e mëtejshëm të veprimtarisë institucionale. Ndër të tjera, Komisioni ka njoftuar: *duke filluar nga data 13 mars 2020, pezullohen afatet për të gjitha vendimet dhe seancat dëgjimore për subjektet e rivlerësimit të publikuara për t'u zhvilluar, do të shtyhen deri në një njoftim të dytë zyrtar*⁸.
- 21.2. Vendimi i Komisionit nr. 244, datë 05.03.2020, rezultoi se i është komunikuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 03.08.2020, në adresën postare: *rruga "{***}"*, ndërtesa nr. {***}, hyrja nr. {***}, ap. {***}, Tiranë 1017. Ky komunikim, referuar lajmërimarrjes përkatëse, me kod {***}, është marrë në dorëzim nga subjekti i rivlerësimit Skënder Haluci më datë 04.08.2020, ku poshtë emrit të subjektit të rivlerësimit, është vënë dhe nënshkrimi përkatës.
- 21.3. Në datën 17.08.2020, në Komision është depozituar nga ana e subjektit të rivlerësimit shkresa e Komisionit me nr. {***} prot., datë 03.08.2020, me anë të së cilës i është përcjellë subjektit të rivlerësimit vendimi i Komisionit. Në këtë shkresë, subjekti i rivlerësimit ka bërë një shënim me shkrim dore, me përmbajtje: *[...] Me vendimin nr. 244, dt. 05.03.2020, jam njohur në datën 14.08.2020, rreth orës 22:00, nga bashkëshortja ime, së cilës ky vendim i është dorëzuar nga një kamerier i lokalit poshtë pallatit në këtë datë. Duke e konsideruar këtë njoftim si në kundërshtim me procedurat ligjore, qëndrimet e mia do t'i relatoj në ankim.*
22. Referuar legjislacionit të zbatueshëm, vendimi me shkrim i Komisionit, lidhur me rivlerësimin, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore. Mënyra e njoftimit të vendimit subjektit të rivlerësimit, është e përcaktuar shprehimisht në nenin 46 të ligjit nr. 84/2016. Referuar dispozitës

⁸ Shih njoftimin e Komisionit në linkun: <https://kpk.al/njoftim-145/56/>.

në fjalë, si rregull, njoftimi bëhet në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit, të deklaruar sipas nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Në pamundësi të njoftimit sipas pikës “1”, njoftimi kryhet sipas formave të tjera të komunikimit të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative, “Pjesa e shtatë”, Kreu II (njoftimi me postë, dorëzimi personalisht, nëpërmjet një të treti, nëpërmjet njoftimit publik, botimit zyrtar).

23. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se praktika e ndjekur nga Komisioni për kryerjen e njoftimeve, nuk ka respektuar parashikimet e nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit, si mënyrë parësore e komunikimit për efekt të kryerjes së njoftimeve, përcaktohet ajo nëpërmjet adresës elektronike të deklaruar gjatë procesit të rivlerësimit dhe, vetëm në pamundësi të realizimit të njoftimit nëpërmjet adresës elektronike, njoftimi kryhet sipas mënyrave të tjera si më sipër cituar.
24. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues nuk konstatoi vonesë në njoftimin e vendimit nëpërmjet shërbimit postar dhe as problematika në drejtim të marrjes dijeni nga ana e subjektit të rivlerësimit, të përmbajtjes së vendimit të Komisionit, referuar lajmërimarrjes së shërbimit postar. Pretendimet e subjektit për vonesë në marrjen dijeni të vendimit të Komisionit mbeten në nivel deklarativ, për sa kohë nuk ka asnjë akt që të provojë që në datën 04.08.2020, dorëzimi i vendimit nga shërbimi postar nuk i është bërë subjektit të rivlerësimit, sikundër referohet në lajmërimarrje, por një personi të panjohur dhe se nënshkrimi i vendosur poshtë emrit të subjektit nuk i përket atij. Edhe gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë provë në drejtim të këtij fakti të pretenduar prej tij.
25. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se pavarësisht se njoftimi i vendimit të Komisionit nuk ka respektuar afatin e përcaktuar në nenin 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues e gjeti të justifikuar këtë vonesë të diktuar nga shkaqe që nuk lidhen me veprimtarinë e Komisionit dhe kanë qenë përtej kontrollit të këtij të fundit. Në çdo rast, trupi gjykues konstatoi se kjo vonesë nuk ka cenuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për akses në gjykatë, sa kohë ky i fundit ka ushtruar ankim brenda afatit ligjor dhe ankimi i tij është marrë në shqyrtim nga Kolegji në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi.
26. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka cenuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për proces të rregullt ligjor në kuptim të parashikimeve të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së, në drejtim: (i) të mosrespektimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, për sa kohë i njëjti trup gjykues që ka bërë hetimin administrativ, analizimin e provave, i njëjti trup gjykues (me të njëjtët anëtarë) ka dhënë edhe vendimin përfundimtar në rolin e gjyqtarit; (ii) të paragjykit të çështjes për shkak se vendimmarrja e Komisionit për mbylljen e hetimit, bazuar vetëm në kriterin e pasurisë, tregon për vendimmarrje të paracaktuar. Sipas subjektit të rivlerësimit, vendimmarrja e Komisionit mund të bazohet vetëm në një kriter, por, në çdo rast, procesi i rivlerësimit, referuar nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, bëhet bazuar në të tria kriteret.
27. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues rikonfirmon qëndrimin e mbajtur në vendimmarrje të mëparshme të Kolegjit, sipas së cilave pretendime të tilla janë gjetur të pabazuara në ligj, me arsyetimin se veprimtaria e trupit gjykues të Komisionit, kompetencat e tij në kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mënyra e ushtrimit të tyre janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, kontrolli i kushtetutshmërisë së të cilit është vlerësuar edhe nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 2, datë 18.01.2017. Trupi gjykues vëren se në të njëjtin konkluzion, për moscenim të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së, ka arritur edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen gjyqësore Xhoxhaj kundër Shqipërisë, në drejtim të vlerësimit të pretendimeve të ngjashme të kërkueses lidhur me cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.

28. Në shqyrtim të shkakut të ankimit se vendimmarrja e Komisionit mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit vetëm për një kriter, përbën paragjykim, trupi gjykues çmoi se ky pretendim i subjektit është i pabazuar në fakte dhe në ligj. Kolegji ka arritur në këtë përfundim referuar parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit Komisioni merr vendim bazuar në një ose disa prej kriterëve të rivlerësimit. Kjo dispozitë ligjore, e vlerësuar në harmoni me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit Komisioni u kalon barrën e provës subjekteve të rivlerësimit në momentin që ai arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, bën që vendimmarrja e Komisionit në këto raste, bazuar mbi parashikimet e mësipërme ligjore, të mos jetë as paragjyqese dhe as e paracaktuar. Kjo vendimmarrje e trupit gjykues është tashmë e konsoliduar, referuar jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit.
29. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 1, duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e dyfishtë të pasurisë së ligjshme, si dhe në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur kjo dispozitë ligjore kërkon plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të dy kriterëve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë, trupi gjykues sjell në vëmendje se tashmë Kolegji ka krijuar jurisprudencë të konsoliduar në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me raportin e pavarur që kanë këto dy dispozita në prodhimin e pasojës juridike të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Sikundër dhe sa i takon mënyrës së vlerësimit të secilit kriter rivlerësimi (atij të pasurisë dhe pastërtisë së figurës), e cila është e pavarur dhe mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nëse deklarimi i subjektit për secilin kriter objekt shqyrtimi vlerësohet i pamjaftueshëm. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se ky pretendim është i pabazuar në ligj dhe nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e vlefshmërisë së vendimit të Komisionit në drejtim të sa më sipër.
30. Lidhur me shkakun e ngritur në ankim se vendimi i Komisionit nr. 244, datë 05.03.2020, është marrë bazuar në fakte të pavërteta që nuk i përgjigjen realitetit dhe provave që janë paraqitur, të cilat, sipas subjektit të rivlerësimit, provojnë bindshëm dhe pa mëdyshje fakte të cilat janë mohuar apo keqinterpretuar në vendim, trupi gjykues konstatoi se ky shkak ankimi është artikulluar në mënyrë të përgjithshme dhe nuk mundësoi vlerësimin e bazueshmërisë së tij në kuptim të vlerësimit të pretendimeve konkrete të subjektit të rivlerësimit dhe evidentimit të fakteve të pavërteta apo fakteve të mohuara apo keqinterpretuara nga Komisioni. Në çdo rast, në vlerësim të trupit gjykues, shqyrtimi i këtij shkak bëhet pjesë e analizës së shkaqeve të ngritura në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe kundërshtimit nga ana e subjektit të rivlerësimit të konkluzioneve të Komisionit, të cilat kanë çuar në vendimmarrjen objekt kontrolli.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

31. Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të njëanshëm dhe në tejkallim të kompetencave që i jep ligji, të konkluzionit të Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament papafingo” me sip. 242 m², në katin e tretë të një ndërtese në rrugën “{***}”, Sauk, Tiranë, në proces legalizimi, trupi gjykues konstatoi si vijon.
32. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të

ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ndër të tjera, si vijon: *Në përfundim, Komisioni, për këtë pasuri, arriti në përfundim se: Komisioni krijoi bindjen bazuar në përgjigjet e subjektit, si dhe aplikimin për legalizim lidhur me kontributin e bërë nga subjekti i rivlerësimit dhe dy vëllezërit e tij për këtë pasuri. Vlera e investimit të subjektit për këtë pasuri është llogaritur në raport me kontributin e tij, pra, respektivisht 1/3 e vlerës së gjithë pasurisë objekt ndërtimor. Subjekti nuk ka deklaruar dhe provuar vlerën e saktë të ndërtimit të këtij objekti ndërtimor dhe në veçanti të pjesës së tij takuese. Vlera e pasurisë është llogaritur bazuar në çmimin mesatar të kostos të ndërtimit për vitet 1997 - 2005, sipas deklarimit të subjektit lidhur me periudhën e ndërtimit të pasurisë objekt ndërtimor. Sipas kësaj llogaritjeje, vlera e ndërtimit, duke marrë parasysh 1/3 e sipërfaqes totale të ndërtimit dhe çmimin mesatar të kostos së ndërtimit për periudhën 1997 – 2005, është 6,958,568 lekë. Subjekti rezultoi në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie. Kjo shihet qartë në rezultatin financiar të pasqyruar në vijim në vendim, për të gjithë periudhën 1997 – 2005, ku një ndikim në rezultat ka pikërisht edhe investimi i bërë në ndërtimin e kësaj pasurie. Subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm dhe mundësitë financiare të vëllezërve të tij për ndërtimin e pjesës tjetër të objektit ndërtimor, pra, për 2/3-n e të gjithë sipërfaqes së objektit ndërtimor. Lidhur me këtë pasuri, rezultoi se subjekti ka bërë deklarim të pasaktë, si dhe është në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie me burime të ligjshme.*

33. Subjekti i rivlerësimit, shkakun e ngritur në ankim për kundërshtimin si të njëanshëm dhe në tejkalim të kompetencave që i jep ligji të konkluzionit të Komisionit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe se është në pamundësi financiare për krijimin e saj me burime të ligjshme, e mbështeti në pretendimet e mëposhtme.

33.1. Komisionerët dhe këshilltarët ligjorë apo ekonomikë të Komisionit nuk janë ekspertë të licencuar në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme dhe në bazë të legjislacionit shqiptar, përcaktimi i vlerës së pasurive të paluajtshme kryhet nga ekspertë të licencuar të fushës. Në lidhje me vlerën e ndërtimit të objektit, subjekti pretendon se ka deklaruar vlerën reale të tij dhe se një pjesë e mirë e punimeve të ndërtimit janë kryer nga familjarët (vëllezërit) dhe se shpenzimet e subjektit kanë qenë për blerjen e materialeve të ndërtimit. Për efekt prove, subjekti ka paraqitur në Komision një akt vlerësimi të objektit të hartuar nga një ekspert i licencuar në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, sipas të cilit vlera e investuar për pjesën takuese, është përlllogaritur në vlerën 2.000.000 lekë.

33.2. Përcaktimi i vlerës së objektit sipas kostove të EKB-së, për vitet përkatëse, nuk i përgjigjet realitetit, pasi kostot e përlllogaritura nga EKB-ja përfshijnë pagesat për kompanitë e ndërtimit (kostot e punëtorëve dhe specialistëve të ndërtimit, fitimit të kompanisë së ndërtimit), ndërkohë që punimet janë kryer nga familjarët e subjektit dhe për to nuk është paguar kosto pune.

33.3. Konkluzioni i Komisionit për pasaktësi në deklarimin e sipërfaqes totale të objektit nga ana e subjektit të rivlerësimit, është i gabuar. Në kontekst të sa më sipër, subjekti pretendoi se nuk ka pjesë takuese në pjesën e poshtme të sipërfaqeve ndërtimore pasi ato u takojnë vëllezërve të tij.

33.4. Subjekti kundërshtoi konkluzionin e Komisionit dhe kalimin e barrës së provës lidhur me gjetjen se ndërtimi është kryer pa leje ndërtimi, me pretendimin se aplikimi për leje ndërtimi nuk është kryer për arsye se nuk ishte zgjidhur plotësisht dokumentacioni i pronësisë së truallit dhe se, në kohën kur është ndërtuar objekti, ligji e cilësonte këtë situatë si kundërvajtje administrative. Subjekti pretendoi standard të dyfishtë sjelljeje nga ana e Komisionit lidhur me kalimin e barrës

së provës për sa më sipër, duke qenë se sipas tij, në një vendim⁹ tjetër, Komisioni, për të njëjtën situatë faktike, ka mbajtur qëndrim të ndryshëm, jopenalizues për subjektin e rivlerësimit.

33.5. Lidhur me përllogaritjen e vlerës së objektit dhe, rrjedhimisht, përcaktimin e vlerës takuese, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të padrejtë ngarkimin e 100% të vlerës së objektit këtij të fundit, në kushtet kur, sipas tij, ai zotëron vetëm katin e tretë të papërfunduar, me sipërfaqe 242 m².

33.6. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka tejkaluar kompetencat duke kërkuar të provohet ligjshmëria e burimit të pasurive të vëllezërve të tij, duke shkelur në këtë mënyrë ligjin dhe praktikën e Kolegjit. Subjekti i rivlerësimit e mbështeti këtë shkak ankimi në pretendimin se fakti që toka mbi të cilën është ndërtuar është blerë vetëm prej tij, nuk mund të përbëjë provë që i gjithë ndërtimi është bërë dhe disponohet prej tij, duke qenë se vëllezërit e tij kanë investuar në këtë objekt dhe ky fakt konstatohet lehtësisht, jo vetëm nga formulari i vetëdeklarimit, por edhe nga fakti që ata nuk kanë asnjë banesë tjetër apo ndonjë kontratë qiraje.

- 34.** Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, fillimisht lidhur me pretendimin se komisionerët apo këshilltarët ekonomikë dhe/apo ligjorë të Njesisë së Shërbimit Ligjor të Komisionit nuk janë ekspertë të licencuar në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, duke nënkuptuar që verifikimi i burimeve të ligjshme për ndërtimin e pasurisë objekt kontrolli duhet të kryhet sipas vlerës së objektit të përcaktuar në aktin e vlerësimit të kësaj pasurie nga ekspertja vlerësuese, ing. E. L., dorëzuar në Komision nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim është i pabazuar në ligj dhe në praktikën tashmë të konsoliduar të Kolegjit.
- 35.** Referuar parashikimeve të nenit 23, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, detyra kryesore e këshilltarëve ekonomikë të Njesisë së Shërbimit Ligjor të institucioneve të rivlerësimit është përgatitja e relacionit të çështjes, veçanërisht për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Kjo detyrë ligjore përmbushet nga këshilltarët ekonomikë, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, si dhe në referim të standardeve të vendosura nga Kolegji në drejtim të çështjeve që lidhen me mënyrën e vlerësimit të pasurive të subjekteve të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me ta. Në kuadër të sa më sipër, në përputhje me standardet e vendosura nga jurisprudenca e Kolegjit, në të gjitha rastet kur subjektet nuk mund të provojnë me dokumentacion justifikues (situacione punimesh, fatura tatimore) koston për ndërtimin e objekteve në pronësi apo posedim të subjekteve të rivlerësimit apo të personave të lidhur me ta, është detyrë e Njesisë së Shërbimit Ligjor që të përllogarisë vlerën e pasurisë në drejtim të koston së investuar për ndërtimin e saj, sipas çmimeve të miratuara nga EKB-ja, referuar vitit/viteve në të cilat është kryer ndërtimi. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se Komisioni ka vepruar drejt në përputhje me ligjin dhe standardet e vendosura në kuadër të procesit të rivlerësimit, sa i takon përllogaritjes së vlerës së ndërtesës dhe pjesës takuese të subjektit të rivlerësimit, sipas kostove të ndërtimit të miratuara nga EKB-ja. Komisioni me të drejtë ka konstatuar se në aktin e vlerësimit të pasurisë nga ing. E. L., përcaktimi i vlerës së investimit nga ekspertja nuk përkonte me koston e EKB-së, të cilat ajo i ka përmendur në aktekspertim si vlerë reference. Vlera prej 8.264 lekësh/m² sipërfaqe ndërtimi, e aplikuar nga ekspertja në aktvlerësimin e pasurisë objekt kontrolli, konstatohet të jetë rezultat i përllogaritjes nga pjesëtimi i vlerës së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si vlerë investimi (2.000.000 lekë) me sipërfaqen e papafingos (242 m²) dhe jo rezultat i përllogaritjeve të koston që i atribuohet 1 metri katror sipërfaqeje ndërtimi, në kuptim të volumit të punimeve të kryera, referuar gjendjes së objektit në fazën përkatëse të punimeve të tij. Për më tepër, konstatohet se fakti që punimet janë

⁹ Subjekti referon këtu vendimin e Komisionit nr. 54, datë 31.07.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit M. B..

shtirirë në disa vite, për të cilat referuar akteve nënligjore në fuqi, çmimet e miratuara për ndërtimet e EKB-së janë të ndryshme, e bën akoma dhe më të diskutueshëm çmimin fiks të përlllogaritur nga ekspertja, në vlerën e 8.264 lekëve/m² sip. Ndërtimi, përgjatë periudhës 1997-2002. Në këto kushte, trupi gjykues e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit për mosmarrjen në konsideratë të aktit të vlerësimit të pasurisë objekt kontrolli nga ana e ing. E. L. dhe përlllogaritjen e vlerës së objektit sipas çmimeve përkatëse të kostos, të miratuara për ndërtimet e EKB-së.

36. Trupi gjykues e vlerësoi të pabazuar në fakte edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit të parashtruar në paragrafin 33.2, në drejtim të moszbritjes nga vlera e përlllogaritur, të kostove të pretenduara nga subjekti si të pazbatueshme në kontekstin e një ndërtimi informal, sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk provoi që kostoja e punëtorisë në ndërtimin e pasurisë objekt kontrolli, ka qenë zero lekë. Fakti i përfshirjes në ndërtim të familjarëve të subjektit të rivlerësimit, nuk përbën provë të vlerësimit me kosto zero lekë të komponentit të punëtorisë. Ky konkluzion vjen në linjë të vendimmarrjeve më të fundit të Kolegjit, në drejtim të pretendimeve të ngjashme në situata ndërtimesh informale¹⁰.
37. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit për konkluzion të gabuar të Komisionit, sipas të cilit subjekti ka kryer deklaram të pasaktë të sipërfaqes totale të objektit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi se në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Një apartament, papafingo e papërfunduar me sipërfaqe 242 m², në proces legalizimi, në katin e tretë të një ndërtese [...]*. Ndërkohë, referuar formularit të vetëdeklarimit pranë ALUIZNI-t, subjekti i rivlerësimit dhe dy vëllezërit e tij kanë deklaruar në kuadër të të dhënave urbanistike të objektit të ndërtuar pa leje, si vijon: *Shtëpi banimi për tri familje, sipërfaqe e ndërtimit 242 m², numri i kateve mbi tokë 3, nën tokë 1*. Në rubrikën “Objekte të tjera brenda sipërfaqes së zënë në shërbim të objektit kryesor (nëse ka)”, vetëdeklaruesit kanë deklaruar 45 m², në kategorinë “garazh”.
38. Në vlerësim të sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë faktin që: ky ndërtim është bërë me qëllim banimin e tri familjeve, referuar edhe fotove të objektit të ndërtuar sipas të cilit konstatohet se hyrja për në katin e nëntokës (bodrum) sigurohet në të dyja anët e aksesit për në banesë, një hyrje drejtpërdrejt nga rruga “{***}”, nga e cila sigurohet aksesimi në pjesën e veçuar me kafaz shkallësh më vete për në katin e tretë të banimit, në posedim të subjektit të rivlerësimit, si dhe një hyrje nga rruga e brendshme e bllokut të banimit, nëpërmjet së cilës sigurohet aksesimi në dy katet e para të banimit të godinës trekatëshe, në posedim të dy vëllezërve të subjektit të rivlerësimit – në mungesë të fakteve që provojnë se kati i nëntokës është ndërtuar dhe përdoret, vetëm nga dy vëllezërit e subjektit të rivlerësimit, prezumohet se sipërfaqja e katit nën tokë, në të cilin ndodhen edhe 45 m² garazh, është në përdorim të të tria familjeve dhe se subjekti i rivlerësimit nuk është i përjashtuar nga bashkëpronësia mbi këtë sipërfaqe ndërtimore, për më tepër që, sikundër ai vetë pretendoi dhe u provua nga aktet e regjistrimit në ZVRPP Tiranë, toka mbi të cilën është ngritur ky objekt 3-katësh, është në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Në kuadër të analizës së mësipërme, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe dispozitat e Kodit Civil, sipas të cilit deri në një ndarje të pasurisë, të tre vëllezërit do të konsiderohen bashkëpronarë në pjesë të barabarta, referuar edhe parashikimeve të nenit 199 të Kodit Civil, ku parashikohet: *Pjesët e bashkëpronarëve janë të barabarta, gjersa nuk vërtetohet e kundërta*.
39. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se me të drejtë Komisioni ka vlerësuar se pjesa takuese e subjektit të rivlerësimit në objektin 3-katësh përfshin edhe 1/3 e sipërfaqes së

¹⁰ Shih arsyetimin e Kolegjit në vendimin nr. 34, datë 15.11.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit I. Sh..

katit nën tokë. Nga kontrolli i ushtruar nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor lidhur me verifikimin e saktësisë së llogaritjeve të kryera nga Komisioni në drejtim të përcaktimit të sipërfaqes takuese të subjektit të rivlerësimit dhe, në vijim, në vlerësimin e kostos së objektit sipas vlerave të EKB-së në lekë për m² sipërfaqe ndërtimi, trupi gjykues konstatoi se, sipas Komisionit, pjesa takuese e subjektit të rivlerësimit në godinën 3-katëshe ishte përcaktuar si 1/3 pjesë e sipërfaqes totale të godinës prej 842 m², konkretisht 281 m², dhe jo si shumatore e sipërfaqes së katit të tretë (papafingos me sip. 242 m²) dhe 1/3 së sipërfaqes së katit nëntokë prej 200 m², sipas së cilës sipërfaqja takuese do të kapte vlerën e 308,7 m². Referuar sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se në mungesë të të dhënave zyrtare lidhur me sipërfaqen e pjesës takuese të subjektit të rivlerësimit në godinën 3-katëshe, duke qenë se ky objekt ndërtimor në momentin e kontrollit ishte në proces legalizimi, Komisioni, në përlllogaritjet e kryera në drejtim të përcaktimit të sipërfaqes takuese, ka pasur një qasje në favor të subjektit të rivlerësimit.

40. Ndërkohë, nga kontrolli i ushtruar në drejtim të saktësisë së përlllogaritjeve të kostos së ndërtimit për sipërfaqen e mësipërme takuese, trupi gjykues konstatoi se çmimi mesatar për ndërtimin e kryer në periudhën e viteve 1997-2005, referuar të dhënave zyrtare të EKB-së¹¹, rezultoi në vlerën e 22.715 lekëve/m² sipërfaqe ndërtimi¹², i cili konstatohet të jetë më i ulët se ai i aplikuar nga Komisioni (24.793 lekë/m² sipërfaqe ndërtimi) në përlllogaritjet e tij. Për rrjedhojë, trupi gjykues arriti në konkluzionin se vlera e objektit duhej të rillogaritej sipas çmimit mesatar prej 22.715 lekësh/m² sipërfaqe ndërtimi. Në përfundim të përlllogaritjeve të kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor, rezultoi se për objektin me sipërfaqe 842 m², të ndërtuar në qytetin e Tiranës në periudhën 1997 - 2005, me kosto mesatare (lekë/m²) si më sipër cituar, vlera e objektit përlllogaritet 19.126.030 lekë (842 m² x 22.715 lekë/m² = 19.126.030 lekë). Kjo vlerë e përpjesëtuar për 3 pjesë (referuar numrit të bashkëpronarëve) përlllogaritet në 6.375.343 lekë për pjesë takuese (19.126.030 lekë ÷ 3 pjesë = 6.375.343 lekë), e cila e shpërndarë në mënyrë të barabartë për periudhën 1997-2005 (9 vjet), rezultoi në shumën prej 708.371 lekësh, shumë kjo që përfaqësonte shpenzimin e subjektit të rivlerësimit të ndarë përpjesëtimisht për çdo vit (6.375.343 lekë ÷ 9 vjet = 708.371 lekë), në mungesë të provave për të kundërtën. Ndonëse nga kontrolli i ushtruar nga trupi gjykues nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, analizës së kryer nga Komisioni, rezultoi se vlerat e përcaktuara nga ky i fundit në vendim nuk ishin të sakta pasi paraqiteshin më të larta, ato sërish u çmuan pa efekt domethënës në rezultatin e analizës financiare të kryer për vitet përkatëse pasi përmirësimi i situatës financiare me 64.803 lekë për çdo vit (në periudhën 1997 - 2005) dhe me 583.225 lekë në total për periudhën 1997-2005, gjatë së cilës është investuar për ndërtimin e objektit, ishte i papërfillshëm në raport me vlerat e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të rezultuara në analizën financiare të këtyre viteve, të vlerësuara individualisht apo edhe si periudhë¹³.
41. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për konkluzion të gabuar dhe standard të dyfishtë sjelljeje nga Komisioni në drejtim të kalimit të barrës së provës subjektit të rivlerësimit lidhur me gjetjen se ndërtimi është kryer pa marrë leje ndërtimi, trupi gjykues, pasi kontrolloi vendimin e Komisionit, konstatoi se ky i fundit nuk ka arritur në ndonjë konkluzion i cili të ketë sjellë pasoja juridike, qoftë në drejtim të vlerësimit të pasurisë objekt kontrolli, qoftë në drejtim të

¹¹ <https://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit>.

¹² Çmimi prej 22.715 lekësh/m² sipërfaqe ndërtimi është përlllogaritur si mesatarja aritmetike e çmimeve për njësi për sipërfaqe ndërtimi, respektivisht për vitin 1997 në vlerën e 16.567 lekëve/m², për vitin 1998 në vlerën e 20.033 lekëve/m², për vitin 1999 në vlerën e 20.033 lekëve/m², për vitin 2000 në vlerën e 24.780 lekëve/m², për vitin 2001 në vlerën e 28.641 lekëve/m², për vitin 2002 në vlerën e 22.150 lekëve/m², për vitin 2003 në vlerën e 22.615 lekëve/m², për vitin 2004 në vlerën e 24.446 lekëve/m², dhe për vitin 2005 në vlerën e 25.168 lekëve/m².

¹³ Shih tabelën e analizës financiare për periudhën 1996-2016, të paraqitur në faqen nr. 35 të vendimit të Komisionit.

sjelljes dhe etikës së subjektit të rivlerësimit, pasoja këto të cilat të lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me faktin e ndërtimit nga ana e subjektit të rivlerësimit, në shkëlqje të legjislacionit në fuqi për urbanistikën. Trupi gjykues vë re se pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim janë përsëritje e shpjegimeve të dhëna në Komision, në kundërshtim të rezultateve të hetimit dhe, për rrjedhojë, u referohen gjetjeve fillestare nga hetimi administrativ i Komisionit, gjetje këto për të cilat Komisioni nuk ka konkluduar në disfavor të subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim nuk është relevant në drejtim të kundërshtimit të konkluzionit të Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë objekt kontrolli dhe, si i tillë, nuk mund të ndikojë në shqyrtimin e shkakut të ngritur në ankim për kundërshtimin si të gabuar të konkluzionit të Komisionit për deklarim të pasaktë dhe mungesë burimesh të ligjshme në krijimin e pasurisë objekt kontrolli.

42. Sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit në drejtim të përcaktimit të pjesës takuese se Komisioni i ka ngarkuar në mënyrë të padrejtë 100% të vlerës së objektit, ndërkohë që, sipas tij, ai zotëron vetëm katin e tretë (të papërfunduar), me sipërfaqe 242 m², trupi gjykuesi, pasi konstatoi se edhe në këtë rast në ankim subjekti ka përsëritur kundërshtimet e tij ndaj gjetjeve fillestare të Komisionit nga hetimi administrativ, vlerësoi se ky pretendim është i pabazuar në fakte dhe, rrjedhimisht, nuk mund të shërbejë si mbështetje për shkakun e ankimit objekt shqyrtimi. Në arritjen e këtij përfundimi, trupi gjykues mbajti parasysh se Komisioni në përfundim të procesit të kontrollit të ushtruar lidhur me vlerësimin e pasurisë, ndërtesë 3-katëshe në Sauk, ka arritur në konkluzionin: *Komisioni krijoi bindjen, bazuar në përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, si dhe në aplikimin për legalizim lidhur me kontributin e bërë nga subjekti i rivlerësimit dhe dy vëllezërit të tij për këtë pasuri. Vlera e investimit për këtë pasuri është llogaritur në raport me kontributin e tij, pra respektivisht 1/3 e vlerës së gjithë pasurisë objekt ndërtimor.*
43. Në lidhje me shqyrtimin e pretendimit të subjektit të rivlerësimit për tejkallim të kompetencave nga ana e Komisionit në lidhje me çështjen e ligjshmërisë së burimeve të vëllezërve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pasi kontrolloi arsyetimin e Komisionit, konstatoi se ky i fundit është shprehur në vendimin e tij lidhur me kontrollin e pasurisë objekt shqyrtimi se ka arritur në këto konkluzione: *Komisioni krijoi bindjen bazuar në përgjigjet e subjektit, si dhe aplikimin për legalizim lidhur me kontributin e bërë nga subjekti i rivlerësimit dhe dy vëllezërit e tij për këtë pasuri. Vlera e investimit të subjektit për këtë pasuri është llogaritur në raport me kontributin e tij, pra respektivisht 1/3 e vlerës së gjithë pasurisë objekt ndërtimor. [...] Subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm dhe mundësitë financiare të vëllezërve të tij për ndërtimin e pjesës tjetër të objektit ndërtimor, pra, për 2/3 e të gjithë sipërfaqes së objektit ndërtimor.*
44. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues çmoi se për sa kohë Komisioni ka konkluduar se vlera e investimit të subjektit për këtë pasuri është llogaritur në raport me kontributin e tij, pra respektivisht 1/3 e vlerës së gjithë pasurisë objekt ndërtimor, Komisioni ka pranuar se pjesa tjetër e investimit është kryer nga dy vëllezërit e subjektit të rivlerësimit. Ndodhur në këto kushte, Komisioni, referuar parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk mund t'i kërkonte subjektit të rivlerësimit përbushjen e detyrimit për të justifikuar burimet e ligjshme për kryerjen e investimit nga vëllezërit e tij, si dhe t'i atribuonte subjektit të rivlerësimit pasojat e mospërbushjes së detyrimit ligjor të parashikuar nga dispozita e sipërcituar, për sa kohë marrëdhënia e subjektit me vëllezërit e tij nuk u provua nga Komisioni të ishte një marrëdhënie juridike huadhënie/huamarrje apo dhurimi. Gjithashtu, sa kohë nuk rezultoi që Komisioni të kishte gjetje në drejtim të deklarimeve fiktive për posedim të dy kateve të poshtme nga vëllezërit e subjektit të rivlerësimit, çka do të orientonte analizën në drejtim të dyshimeve për fshehje të pasurisë, atribuimi i pasojave të mospërbushjes së detyrimit ligjor sipas parashikimit të nenit 32,

pika 4 e ligjit nr. 84/2016, vetëm në kuadër të një marrëdhënieje bashkinvestimi, çmohet nga trupi gjykues jo në përputhje me kërkesat e dispozitës së sipërcituar ligjore dhe praktikës së deritanishme të Kolegjit në interpretimin dhe zbatimin e saj.

45. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues e gjeti të drejtë dhe të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka vepruar në shkelje të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe, në kundërshtim me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, sa i takon çështjes së verifikimit të burimeve të ligjshme të personave të tjerë të lidhur, në kushtet kur vetë Komisioni ka arritur në konkluzionin se investimi për ndërtimin e objektit 3-katësh është kryer nga të tre vëllezërit në raportet 1:1:1. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm dhe mundësitë financiare të vëllezërve të tij në ndërtimin e pjesës tjetër të objektit ndërtimor, nuk mund të sjellë pasoja juridike në vlerësimin e pasurisë objekt kontrolli *“apartament papafingo me sip. 242 m²” në katin e tretë të një ndërtese në rrugën “{***}”, Sauk-Tiranë* dhe, për rrjedhojë, nuk mund të shërbejë si shkak për vlerësimin e kësaj pasurie në kuadër të procesit të rivlerësimit.
46. Në përmbyllje të analizës së mësipërme lidhur me këtë shkak të ankimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues arriti në përfundimin se për pasurinë e paluajtshme të llojit *“apartament papafingo”*, me sipërfaqe 242 m², në katin e tretë të një ndërtese të ndodhur në Sauk, Tiranë, në proces legalizimi, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe ka rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për ndërtimin e pjesës së tij takuese, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, gerrat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit për deklaram të pamjaftueshëm të kësaj pasurie në kuadër të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, gjendet i drejtë dhe i bazuar.
47. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “tokë arë” me sipërfaqe 1400 m², me nr. pasurie {***}, ZK nr. {***}, me vendndodhje në Sauk, Tiranë, fituar me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.01.2015, përpara noterit publik Y. Ç., për të cilën subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzioni i Komisionit lidhur me krijimin e kësaj pasurie, është arritur në shtrembërim të fakteve dhe provave të vëna në dispozicion nga ana e tij, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
48. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ndër të tjera, si vijon: *Në përfundim, Komisioni, për këtë pasuri, arriti në përfundim se: Subjekti ka bërë deklaram të rremë në deklaramtën “vetting” lidhur me vlerën e blerjes së pasurisë tokë, me sip. 1.400 m², deklaruar në vlerën 140.000 lekë. Subjekti ka bërë deklaram të pasakta ndër vite dhe në deklaramtën “vetting”, lidhur me vitin e blerjes dhe vlerën e blerjes së pasurisë tokë arë. Subjekti ka deklaruar që toka është blerë në vitin 1997 nga shtetasi I.Z., në vlerën 1.400.000 lekë si pronar i tokës, por rezultoi se ky shtetas nuk dispononte dokument pronësie në atë periudhë për këtë pasuri. Nga provat e paraqitura nga subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, rezulton se shtetasi I.Z., ka blerë në datën 07.03.2001, një sipërfaqe toke prej 17.750 m². Më pas, pjesë të ndryshme të kësaj pasurie ua ka shitur nga viti 2001 personave të ndryshëm, deri në 2015, kur i ka shitur dhe subjektit të rivlerësimit sipërfaqen 1.400 m². Komisioni konstatoi dhe se kontratat e shitjeve të pasurive nga shtetasi I.Z., duket se janë me çmime fiktive, pasi bazuar në çmimet e shitjes në raport me sipërfaqet përkatëse, shihet qartë që ato nuk korrespondojnë. Bazuar në deklaramtën noteriale të datës 11.2.2020, me deklarues*

shtetasin I.Z., ky i fundit deklaroi se toka i është shitur subjektit në vlerën 140.000 lekë në vitin 1997, deklarim i cili kundërshton deklarimin e subjektit se kjo pasuri është blerë në vlerën 1.400.000 lekë dhe se është dhënë kapar në vitin 1997. Në këtë periudhë, subjekti ka paguar edhe shumë prej 126.000 lekësh për punimet e kryera nga deklaruesi. Pra, ky deklarim i palës shitëse të pronës (tokë) me sip. 1.400 m², nuk korrespondon me deklaratimet dhe pretendimet e subjektit lidhur me këtë pasuri. Mosdeklarimi i vlerës së saktë nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie, ka sjellë shmangie të detyrimeve financiare në buxhetin e shtetit. Bazuar në analizën financiare, subjekti është në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në datën 10.01.2015¹⁴.

49. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit lidhur me krijimin e kësaj pasurie, si konkluzion të arritur në shtrembërim të fakteve dhe provave të vëna në dispozicion nga ana e tij. Në mbështetje të këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit ka ripërsëritur në ankimin e tij edhe një herë të gjitha shpjegimet e dhëna në Komision në kuadër të barrës së provës që i ka kaluar Komisioni lidhur me rezultatet e hetimit administrativ. Në mënyrë të përmbledhur, subjekti i rivlerësimit parashtroi si vijon.

49.1. Konstatimi i Komisionit për mospërputhje të deklaratimeve lidhur me vitin dhe vlerën e krijimit të kësaj pasurie mes deklaratës së pasurisë *vetting*, deklaratimeve periodike dhe përgjigjeve në pyetësorët e Komisionit, është konstatim i saktë, por kjo mospërputhje, sipas subjektit të rivlerësimit, ka ardhur si pasojë e pakujdesisë së tij. Subjekti pretendoi se në DIPPV-në e vitit 2004, vlera e deklaruar, prej 1.500.000 lekësh, është pikërisht vlera e shpenzuar deri në vitin 2004 për ndërtimin e katit të tretë dhe jo e truallit. Ndërsa vlera e deklaruar në DIPPV-në e vitit 2015, prej 140.000 lekësh, si vlerë e truallit është deklaruar duke iu referuar kontratës së shitjes së paguar prej tij në vitin 2015. Sipas subjektit, kuptimi i tij lidhur me deklarimin e kësaj pasurie ka qenë detyrimi për të deklaruar shpenzimet e kryera në atë vit të deklarimit. Sipas subjektit të rivlerësimit, çmimi i kësaj pasurie të paluajtshme në vlerën e 1.400.000 lekëve u shndërrua në një vlerë më të ulët prej 140.000 lekësh në kontratën e shitjes në vitin 2015, për arsye të mospasqyrimit në kontratën e shitblerjes në vitin 2015, të marrëdhënies së kaparit të krijuar në vitin 1997. Subjekti pretendoi se vlerën e paguar në formën e kaparit në vitin 1997, nuk kishte si ta deklaronte, as në deklaratën për herë të parë të vitit 2003, as në deklarimin periodik të vitit 2004, pasi përveçse nuk kishte fituar të drejta pasurore nga ana juridike, nuk kishte as ndonjë rubrikë në formularin e deklarimit ku të mund të deklaroheshin detyrimet apo të drejtat që vinin nga marrëdhëniet kontraktuale, siç ka qenë marrëdhënia faktike e krijuar mes shitësit dhe subjektit të rivlerësimit, e cila, sipas subjektit të rivlerësimit, cilësohet si kapar në lidhje me një kontratë shitjeje me rezervë të pasurisë së paluajtshme.

49.2. Sa i takon dokumentacionin provues për blerjen e pasurisë në vitin 1997, subjekti pretendoi se në vitin 2004, me qëllim deklarimin e posedimit të ndërtesës 1-katëshe dhe 800 m² oborr, ka formalizuar marrëdhënien e kaparit të dhënë në vitin 1997 në një “deklaratë dore”, por aktualisht është në pamundësi paraqitjeje, pasi kjo deklaratë ka humbur. Subjekti pretendoi se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive sipas parashikimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe,

¹⁴ Referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni, pasuria e llojit “tokë me sip. 1400 m²” është përllogaritur në vlerën prej 37.945.600 lekësh, referuar çmimeve referuese të tokave në vitin e blerjes, dhe verifikimi i mjaftueshmërisë së burimeve financiare lidhur me krijimin e kësaj pasurie, është kryer mbi bazën e vlerës së sipërcituar të pasurisë objekt kontrolli.

për rrjedhojë, ka dorëzuar në Komision një deklaratë noteriale të shitësit, si dhe ka kërkuar të thërritet si dëshmitar shitësi, si dhe personat që ia kanë shitur atij.

49.3. Vlera e tokës e përlllogaritur nga Komisioni nuk i takon as vitit 1997 në të cilin është blerë kjo pasuri, as vitit 2006 në të cilin është vetëdeklaruar ndërtimi mbi këtë pasuri pranë ALUIZNI-t, por i referohet çmimeve të vitit 2015, vit në të cilin është formalizuar shitja me rezervë e kryer faktikisht në vitin 1997. Sipas subjektit të rivlerësimit, përlllogaritja nga ana e Komisionit e vlerës së kësaj pasurie, sipas vlerës së tokës në vitin e formalizimit të blerjes me kontratë, është e pabazuar në ligj¹⁵.

49.4. Subjekti kundërshtoi si të gabuar dhe pa mbështetje ligjore dhe faktike konkluzionin e Komisionit se *duke mos përcaktuar në kontratë vlerën e saktë të blerjes së kësaj pasurie, duket se janë shmangur edhe detyrimet përkatëse në buxhetin e shtetit (duket se është kryer evazion fiskal me deklarimin e vlerës së shitblerjes prej 140.000 lekësh të kësaj pasurie dhe jo të vlerës reale)*. Në mbështetje të këtij shkakut ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi se, referuar parashikimeve të ligjit nr. 7786, datë 27.01.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar, në vitin 1997, për shitblerje të pasurive të paluajtshme deri në vlerën e 2.000.000 lekëve, nuk përcaktohej detyrim për pagesën e tatimeve. Gjithashtu, subjekti pretendoi se në çdo rast, detyrimi ligjor për pagesën e tatimit i ka takuar shitësit që krijon të ardhura nga shitblerja e pasurisë dhe jo blerësit.

49.5. Subjekti kundërshtoi si të pabazuar edhe konkluzionin për pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2015, referuar analizës financiare për këtë vit, me pretendimin se kjo pasuri është blerë në vitin 1997 dhe jo në vitin 2015, në të cilin është formalizuar akti i shitjes dhe është bërë pagesa e vetëm 1/10-s pjesë të çmimit të shitblerjes.

50. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, pas verifikimit të akteve të fashikullit të çështjes, trupi gjykues konstatoi se situata faktike e parashtruar nga Komisioni lidhur me deklaratimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të vitit të krijimit të pasurisë dhe vlerës së blerjes, mes deklaratimeve të tij në deklaratat periodike, në deklaratën e pasurisë *vetting*, në përgjigjet e pyetësorëve të Komisionit, si dhe në raport me deklaratën noteriale të shitësit të pasurisë së paluajtshme, z. I. Z., të datës 11.02.2020, është e saktë dhe rezultoi e konfirmuar edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit, i cili këtë mospërputhje deklarimesh e pretendoi si rrjedhojë të marrëdhënies së kaparit, të paretëfektuar në dokumentacionin ligjor të shitblerjes së tokës në vitin 2015.

51. Në kuadër të vlerësimit të pretendimeve të subjektit në drejtim të ekzistencës së një marrëdhënieje kapari mes tij dhe shitësit të pasurisë objekt kontrolli, z. I. Z., si dhe të vlerësimit të pretendimit mbi pamundësinë për ta deklaruar këtë marrëdhënie në formularët e deklaratimeve ndër vite pranë ILDKPKI-së, me justifikimin se në formularët e ILDKPKI-së mungonte rubrika ku mund të deklarohet një fakt i tillë, trupi gjykues çmoi të marrë në analizë kuadrin ligjor të zbatueshëm, nga ku vlerëson si më poshtë.

51.1. Referuar përcaktimit të dhënë në nenin 601 të Kodit Civil, “Kapari”, i cili përfaqëson shumën në të holla që njëra nga palët i jep tjetrës për llogari të shumës që do t’i paguhet në bazë të kontratës, me qëllim që të vërtetojë lidhjen e kontratës dhe të sigurojë ekzekutimin e saj, trupi gjykues çmoi se në situatën e dhënies së një kapari, nëpërmjet këtij të fundit do të provohej edhe lindja e një marrëdhënieje kontraktuale mes palëve të përfshira, qoftë edhe në formën e një

¹⁵ Subjekti referon në kontekst të sa më sipër, ligjin për legalizimet dhe vendimin nr. 35, datë 10.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese, e cila, sipas tij, ka përcaktuar “mënyrën e kriteret për shpërblimin e pronarëve privatë të shpronësuar”.

premtimi për të shitur në të ardhmen një send apo të një shitjeje me rezervë të pronës, sikundër pretendoi subjekti i rivlerësimit. Në interpretim të parashikimit të nenit 601 të Kodit Civil, trupi gjykues vlerësoi se vlera e paguar në formën e kaparit, ndonëse shërben si formë për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, në vetvete përbën pjesë të çmimit të kontratës së siguruar. Në këtë kuptim, në kontratën e shitblerjes, vlera e paguar paraprakisht në formën e kaparit, do duhet të ishte deklaruar në pjesën që i takonte çmimit të shitblerjes, fakt ky i cili nuk ka ndodhur, sa kohë në *kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.01.2015, përpara noterit publik Y. Ç., çmimi i shitjes së parcelës së tokës me sipërfaqe 1400 m², është deklaruar me vlerë 140.000 lekë, ndonëse u pretendua nga ana e subjektit të rivlerësimit se kjo vlerë ka përbërë vetëm 1/10 e çmimit të shitblerjes.*

51.2. Në vijim të analizës së mësipërme, trupi gjykues çmoi se ekzistenca e një marrëdhënieje kapari si pretenduar nga ana e subjektit të rivlerësimit, në kuptim të detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, duhej të ishte deklaruar në deklaratën periodike përkatëse të vitit 2004, minimalisht në rubrikën e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë/fizikë, nëpërmjet deklaramentit të pjesës së mbetur për t'u paguar, të çmimit të shitblerjes së pasurisë, e cila pritej të formalizohej, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, me marrjen e dokumentacionit nga ana e shitësit¹⁶ dhe pagesës së pjesës së mbetur të çmimit nga ana e subjektit të rivlerësimit.

52. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se, përveçse pretendimet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të ekzistencës së një marrëdhënieje kapari nuk u provuan, pasi në fashikullin e çështjes nuk është administruar asnjë dokumentacion apo qoftë edhe ndonjë e dhënë e cila të mund të shërbente si indicie në drejtim të sa më sipër, por edhe në rastin që trupi gjykues do të pranonte se një marrëdhënie e tillë ka ekzistuar, ajo nuk do të mund të justifikonte vlerën tejet të ulët të pasqyruar në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie në vitin 2015.
53. Sa i takon shqyrtimit të pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit, për konkluzion të gabuar të Komisionit dhe pa mbështetje ligjore lidhur me çështjen e *shmangies së detyrimeve tatimore nëpërmjet deklarimit të vlerës së shitblerjes prej 140.000 lekësh të kësaj pasurie dhe jo të vlerës reale*, trupi gjykues, pasi verifikoi legjislacionin e zbatueshëm në fuqi¹⁷, konstatoi se, referuar dispozitave të ligjit 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, më konkretisht nenit 11, pika 2 e tij, tatimi paguhet nga individit që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të pasurive të mësipërme, në përputhje me aktet ligjore. Në kuptim të këtij parashikimi ligjor, në udhëzimin e ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë nr. 9, datë 26.02.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar, deri në vitin 2015, kur është lidhur kontrata e shitblerjes, parashikohej se: *Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, tokë dhe ndërtesë, tatohet me 10 për qind të fitimeve kapitale të realizuara*. Gjithashtu, referuar pikës 2 të këtij udhëzimi, tatimi paguhej nga personi që kalonte të drejtën e pronësisë para kryerjes së regjistrimit të pasurisë, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, çka nënkupton që vlera e tatimit përcaktohet sipas

¹⁶ Trupi gjykues konstatoi se nga dokumentacioni i administruar nga ZVRPP Tiranë, z. I. Z. është pajisur me dokumentacionin e pronësisë mbi tokën që në vitin 2001 dhe se nga ky vit e deri në vitin 2015, z. I. Z. rezulton të ketë shitur rregullisht pjesë të parcelës së tokës të fituar në vitin 2001, në të cilën bënte pjesë edhe sipërfaqja e tokës objekt kontrolli, ndonëse subjekti i rivlerësimit pretendoi se kontrata e shitblerjes nuk është lidhur më parë në pritje të pajisjes me dokumentacionin e pronës nga shitësi.

¹⁷ Shih parashikimin e nenit 11, pika 2 e ligjit 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; udhëzimin e ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë nr. 9, datë 26.02.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar deri në vitin 2015 kur është lidhur kontrata e shitblerjes.

regjimit tatimor të zbatueshëm në momentin e kryerjes së pagesës së tatimit dhe jo në momentin e pagesës së çmimit të blerjes, apo në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes.

54. Trupi gjykues vlerësoi se edhe në eventualitetin e një kontrate shitjeje me rezervë të pronës (sikundër pretendoi subjekti i rivlerësimit se ishte marrëdhënia e krijuar mes tij dhe shitësit të pasurisë së paluajtshme “tokë arë”, z. I. Z.), sipas së cilës pjesa më e madhe e çmimit është paguar kohë më parë se kësti i fundit, i cili shënon dhe përmbushjen e kushtit për kalimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme, referuar pikës 9.7 të udhëzimit të sipërcituar, tatimi për kalimin e së drejtës së pronësisë së paluajtshme paguhet në momentin kur paguhet kësti i fundit i çmimit të kontratës¹⁸. Për rrjedhojë, në analizë të sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pambështetur në ligj, sa kohë, referuar parashikimeve të legjislacionit të zbatueshëm lidhur me situatën faktike si më sipër konstatuar, pagesa e tatimit do të përcaktohej sipas regjimit tatimor në fuqi në momentin e kalimit të pronësisë dhe jo sipas parashikimeve të legjislacionit në momentin kur mund të jenë paguar vlerat paraprakisht. Ndonëse trupi gjykues konstatoi se pagesa e tatimit në këto raste është detyrim i shitësit që kalon të drejtën e pronësisë së sendit, ky fakt nuk përjashton nga përgjegjësia subjektin e rivlerësimit në favorizimin/pranimin e shmangies së detyrimeve tatimore të përcaktuara me ligj, nëpërmjet dakordësisë për përcaktimin në kontratë të një çmimi shitblerjeje në vlerë më të ulët, sa paguar realisht.
55. Në analizë të konkluzioneve që ka arritur Komisioni lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstatoi se Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer edhe deklaram të rremë, edhe deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me vlerën e pasurisë, ndërkohë që në vlerësim të trupit gjykues, situata faktike në lidhje me deklaramin e kësaj pasurie, nuk mund të vlerësohet në të njëjtën kohë edhe si deklaram i pasaktë, edhe si deklaram i rremë. Në këtë kontekst, trupi gjykues, duke iu referuar situatës faktike të konstatuar nga Komisioni lidhur me deklaramin e vitit dhe vlerës së blerjes së kësaj pasurie, si dhe analizës së këtij të fundit në vendim, konstaton se nga hetimi administrativ, nuk ka rezultuar që Komisioni të ketë arritur në një përfundim sa i takon momentit kohor të shitblerjes së pasurisë dhe vlerës specifike të paguar në formën e çmimit të shitblerjes. Ndërkohë që, për efekt të analizës së kryer për vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni duket që këtë blerje e ka vendosur në vitin 2015, kur është lidhur dhe kontrata noteriale e shitjes mes palëve dhe si vlerë të blerjes nuk ka marrë në konsideratë vlerën e deklaruar në kontratë, por ka bërë një përlllogaritje të tijën mbi bazën e një çmimi reference të shitblerjes së tokave në atë vit. Një linjë e tillë arsyetimi, në vlerësim të trupit gjykues, është e gabuar.
56. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues pretendimet e tij lidhur me vitin dhe vlerën e blerjes së pasurisë, në referim të parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të pranojë si provë të faktit lidhur me vitin dhe vlerën e blerjes, deklaramin e subjektit të rivlerësimit në DIPPV-në e vitit 2004, jo vetëm si deklaramin më të afërt lidhur me momentin e krijimit të kësaj pasurie, por edhe për faktin që ky deklaram u vlerësua si i pandikuar nga nevoja për rregullime në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Për rrjedhojë, edhe akti i dorëzuar bashkëlidhur parashtresave të subjektit të rivlerësimit, me titull “Raport vlerësimi pasurie të paluajtshme”, i datës 01.06.2022, me vlerësues ing. Sh. A. dhe P. K., i cili lidhej me përcaktimin e vlerës së tokës në bazë të çmimeve referuese, u çmua i

¹⁸ Në pikën 9.7 të udhëzimit të ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë nr. 9, datë 26.02.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar deri në vitin 2015 kur është lidhur kontrata e shitblerjes, parashikohet: “Në rastet e shitjes me rezervë të pronës, të parashikuar nga nenet 746-749 të Kodit Civil, tatimi i kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme paguhet në momentin kur paguhet kësti i fundit të çmimit të kontratës”.

panevojshëm në kuptim të parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016, përveçse nuk përmbushte kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012¹⁹. Në këto kushte, analiza lidhur me verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, u kontrollua nga trupi gjykues nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, duke pasqyruar në analizën e kryer nga Komisioni për vitin 2004, si shpenzim për blerjen e pasurisë së paluajtshme të llojit "tokë arë" me sipërfaqe 1400 m², vlerën prej 1.500.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën periodike të këtij viti, si "vlera e truallit 1.500.000 lekë" dhe, njëkohësisht, duke mos llogaritur shumën prej 37.945.600 lekësh, si shpenzim për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2015, sipas arsyetimit të Komisionit në vendim. Në përfundim të këtij kontrolli, rezultoi se subjekti i rivlerësimit në vitin 2004, vit në të cilin është blerë pasuria objekt kontrolli, kishte mungesë burimesh të ligjshme në vlerën e 2.351.447 lekëve²⁰, për krijimin e saj dhe mbulimin e shpenzimeve të kryera.

57. Për rrjedhje të analizës së mësipërme, trupi gjykues e gjen të pabazuar në fakte dhe në ligj shkakun e ngritur në ankim nga subjekti i rivlerësimit për kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit lidhur me kontrollin e pasurisë së llojit "tokë arë" me sipërfaqe 1400 m² në Sauk, Tiranë, mbi të cilën është ndërtuar godina 3-katëshe, dhe përfundimisht vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të paplotë të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe ka rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së saj, në vitin 2004, në vlerën e 1.500.000 lekëve, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, geramat "a" dhe "b" të ligjit nr. 84/2016.
58. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme "tokë arë" me sip. 890 m², të blerë nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në vitin 1999, me vlerë 1.000.000 lekë, për të cilën subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
59. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, në kuadër të kontrollit të kësaj pasurie dikur në pronësi të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, ka arritur në këto konkluzione: *Subjekti nuk ka arritur të paraqesë prova bindëse për të kundërshtuar gjetjet e Komisionit lidhur me këtë pasuri dhe rezultoi në mungesë të mundësive financiare për blerjen e saj, në shumën prej 1.171.476 lekësh. Këtë pasuri subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore për vitet 2003 dhe 2004, të dorëzuara në ILDKPKI.*
60. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratën para fillimit të detyrës, shitjen e saj dhe të ardhurat e krijuara nga ky transaksion në deklaratën periodike të vitit 2004 dhe atë të pasurisë *vetting*. Këtë shkak të ankimit, subjekti e mbështet në pretendimet se: (i) kjo ka qenë pasuri e bashkëshortes së tij, e krijuar para lidhjes së martesës dhe se subjekti nuk ka pasur të drejta pronësie mbi këtë pasuri; (ii) nuk ka investuar në krijimin e kësaj pasurie dhe as ka krijuar të ardhura prej shitjes së saj; (iii) në momentin e kryerjes së deklarimit për herë të parë në datën 13.02.2004, kjo pasuri, sikundër pretendoi subjekti i rivlerësimit, nuk ishte as në pronësi të subjektit dhe as të bashkëshortes së tij;

¹⁹ Në kuadër të parashikimeve të nenit 47, në kombinim me nenin 51, pika 1, shkronja "a" e ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision.

²⁰ Në këtë rezultat financiar, që ndryshon nga ai i Komisionit, kanë ndikuar: (i) ulja e zërit "Shpenzime interesi nga kredia pranë Intesa Sanpaolo Bank" të përlllogaritura nga Kolegji sipas lëvizjeve bankare, në vlerën 486.663 lekë dhe jo 510.531 lekë, sipas përlllogaritjes së Komisionit; (ii) përlllogaritja e zërit "Ndryshim/pakësim në likuiditete në bankë" në vlerën 7.040 lekë, e cila nuk ishte përfshirë në analizë nga Komisioni; si dhe (iii) një vlerë më e ulët e llogaritur për ndërtimin e objektit në rr. "{***}", në shumën prej 708.371 lekësh dhe jo në vlerën 773.174 lekë, referuar analizës në vendim.

(iv) në deklarinimin periodik për vitin 2004, kërkohej deklarimi i pasurive të luajshme dhe të paluajshme të cilat disponoheshin veçmas nga bashkëshortja deri më datë 31.12.2004, ndërkohë që kjo e fundit në këtë datë, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk kishte as pasurinë e sipërcituar në pronësi të saj, as vlerën e përfituar nga shitja e saj.

61. Subjekti kundërshtoi si të gabuar edhe analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 1999, kur është kryer blerja e kësaj pasurie, me pretendimin se: (i) të ardhurat nga paga e bashkëshortes si e punësuar pranë punëdhënësit “{***}”, në mënyrë të padrejtë nuk janë marrë në konsideratë sipas deklarinimit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe vlerës së tyre të referuar në vërtetimin e punëdhënësit me nr. {***}, datë 24.01.2017; dhe se (ii) në mënyrë të padrejtë, janë shtuar edhe shpenzime “kosto ndërtimi shtëpi “{***}”. 1.063.115 lekë”, të cilat, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk janë kryer në këtë vit, duke qenë se, sipas tij, totali i shpenzimeve për ndërtimin e shtëpisë në vlerën prej 1.500.000 lekësh, është kryer në periudhën kohore nga viti 1998 deri në vitin 2004.
62. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi se në datën 26.01.2004, para noterës publike M. Ll., është lidhur një kontratë noteriale shitjeje, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., mes znj. A. S. në cilësinë e shitëses dhe z. B. G. në cilësinë e blerësit, me objekt shitjen e pasurisë së paluajshme të llojit “tokë arë” me sipërfaqe 890 m², me çmim shitjeje 5.000.000 lekë, vlerë e cila është deklaruar në këtë kontratë si *e likuiduar nga palët jashtë kësaj zyre noteriale*. Në datën 13.02.2004, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën për herë të parë, ku do të duhet të deklaronte gjendjen e pasurive të akumuluar prej tij deri në datën e deklarinimit, sipas kërkesave të ish-nenit 6 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003. Në këtë deklaratë, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk ka deklaruar asnjë fakt lidhur me këtë pasuri në pronësi të tij. I njëjti konstatim vlen edhe në drejtim të përmbajtjes së deklaratës periodike të vitit 2004, ku vihet re se nuk ka asnjë deklarinim nga ana e znj. A. S..
63. Referuar parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, subjektet deklaruese detyroheshin të deklarorin në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si parashikuar shprehimisht në këtë nen, ku, ndër të tjera, përcaktoheshin edhe të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale²¹.
64. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se ndonëse në deklaratën për herë të parë, subjekti i rivlerësimit nuk kishte detyrim të deklaronte në rubrikën e pasurive pronësinë e bashkëshortes në lidhje pasurinë e paluajshme “tokë arë” me sip. 890 m², me vendndodhje në Sauk, Tiranë, për sa kohë në datën e dorëzimit të deklaratës, kjo pasuri nuk ishte më në pronësi të saj, në referencë të detyrimeve të parashikuara nga ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, si dhe nga parashikimet e ligjit nr. 84/2016, subjekti do të duhet të kishte deklaruar nëpërmjet bashkëshortes së tij, në deklaratën periodike të vitit 2004, si dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, të ardhurën e krijuar nga shitja e kësaj pasurie. Pavarësisht sa më sipër, fakti që subjekti dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar likuiditet gjendje *cash*, duke iu referuar të ardhurave të krijuara nga shitja e kësaj pasurie, prezumon faktin që ky likuiditet i krijuar nga shitja e pasurisë më datë 26.01.2004, ishte shpenzuar deri në datën e dorëzimit të deklaratës për herë të parë pranë ILDKPKI-së, më datë 13.02.2004, dhe, për rrjedhojë, nuk mund të shërbente si e hyrë në ekonominë familjare, për efekt të krijimit të pasurive dhe mbulimit të shpenzimeve të krijuara pas kësaj date. Ky fakt vihet re të jetë mbajtur në konsideratë edhe në rezultatin financiar të analizës së kryer nga Komisioni për vitin 2004, pasi

²¹ Shih nenin 4, pika “e” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003.

u konstatua që vlera e krijuar nga shitja e pasurisë objekt kontrolli, është konsideruar me efekt financiar zero.

65. Sa i takon analizës së kryer nga Komisioni lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme të blerjes së kësaj pasurie nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në vitin 1999, lidhur me pretendimet e subjektit në drejtim të vlerësimit nga Komisioni të të ardhurave të bashkëshortes së tij nga punësimi pranë gazetës “{***}” në periudhën prill 1998 – korrik 2005, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi se, lidhur me këto të ardhura të pretenduara, të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting* në vlerën e 13.810.000 lekëve, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë depozituar së bashku me deklaratën e pasurisë një vërtetim të lëshuar nga administratori dhe botuesi i gazetës “{***}”, me nr. {***} prot., datë 24.01.2017. Në këtë shkresë, thuhet: *Dokumente financiare nuk disponohen, por mund të konfirmojmë se znj. A. S. ka qenë juriste në “{***}” për një periudhë 15 prill 1998 deri më 31 korrik 2005, me kohë të pjesshme dhe të plotë. [...] duke marrë në konsideratë pagesën në Sigurimet Shoqërore, përqindjet e reklamave si shpërblim (praktikë e njohur në media), mbulimin e gjyqeve të gazetës, emisionet radiotelevizive etj., përlllogarit se znj. A. S. ka përfituar përafërsisht 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë në muaj për kohën që ka qëndruar pranë gazetës “{***}”.*
66. Gjatë hetimit të kryer nga ana e ILDKPKI-së, referuar vërtetimeve të Drejtorisë së Arkivit të Rajonit Tiranë pranë ISSH-së²² me nr. {***} prot., datë 07.02.2018, me titull “Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare”, respektivisht për periudhat qershor 1998 - dhjetor 2001 dhe janar 2002 deri në korrik 2005, rezultoi se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka qenë e punësuar pranë subjektit “{***}” dhe për të janë paguar kontributet e detyrueshme përkatëse. Referuar këtyre vërtetimeve, nuk provohen vlerat e pagave të deklaruara si të përfituara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit dhe as ato të referuara në vërtetimin e punëdhënësit, gazeta “{***}”. ILDKPKI-ja, në kuadër të hetimit lidhur me çështjen e pagave të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë me gazetën “{***}”, rezultoi se ka administruar gjithashtu edhe një vërtetim, në të cilin shkruhet: *Në lidhje me shkresën tuaj, konfirmojmë momentalisht, pas lëvizjes në zyrë të reja të redaksisë së gazetës, dokumentet e periudhës për të cilën kërkoni të dhëna për znj. A. S. S., e datëlindjes 08.06.1974, dhe punonjësit e tjerë nuk ekzistojnë. Por më saktë, duhet të gjenden në degën e Sigurimeve Shoqërore në Tiranë të dhënat për pagën e saj. Për të mundësuar ndihmën tonë në lidhje për sa kërkoni, mund t’ju konfirmojmë se znj. A. S. ka qenë juriste dhe avokate e shpk “{***}” për periudhën 1998-2005 (gjithnjë nëse nuk gabohet, pasi, siç sqarova, dokumente nuk kemi momentalisht) [...]. Në këtë vërtetim, bie në sy fakti që nuk referohet vlerë page mujore, si referuar në vërtetimin e lëshuar nga i njëjti punëdhënës, me kërkesë të personit të lidhur, znj. A. S., dhe të dorëzuar së bashku me deklaratën e pasurisë *vetting*.*
67. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se në deklaratimet periodike pranë ILDKPKI-së, për vitet 2004 dhe 2005 (në deklaratën për herë të parë, viti 2003, nuk ka asnjë deklaram lidhur me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit), është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit përkatësisht: *pagë 25.000 lekë dhe honorarë ShPK “{***}” për vitin 2004, dhe: paga e bashkëshortes ShPK “{***}”, 325.000 lekë për vitin 2005, vlera këto ndjeshëm më të ulëta se sa pretenduar në vërtetimin e punëdhënësit nr. {***} prot., datë 24.01.2017, mbi bazën e të cilit është përlllogaritur dhe niveli i pagave të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*.*

²² Sipas 2 shkresave të Drejtorisë së Arkivit të Rajonit Tiranë pranë ISSH-së, të dyja me nr. {***} prot., datë 07.02.2018.

68. Në analizë të sa më sipër konstatuar, në kushtet e mungesës së kontratës së punës që provon ndër të tjera natyrën e punës së dakordësuar mes punëdhënësit “{***}” dhe bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, si dhe vlerën e pagës përkatëse, për më tepër në mungesë edhe të të dhënave mbi pagesat e përfituara nga kjo marrëdhënie pune (lëvizjet bankare apo listëpagesat), dhe duke mbajtur në konsideratë faktin që pagat e deklaruara në DIPPV-të për vitet 2004 dhe 2005, që i takojnë marrëdhënies së punësimit në gazetën “{***}”, janë dukshëm më të ulëta sesa deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, trupi gjykues arriti në përfundimin se me të drejtë Komisioni ka konkluduar që për efekt të këtij procesi, të vetmet të ardhura që plotësojnë standardin e të ardhurave të ligjshme, sipas parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe provohen si të tilla, janë ato të ardhura të konfirmuara nga vërtetimet e ISSH-së, sa kohë subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e sa më sipër. Në këto kushte, vlerësohet e drejtë përfshirja në analizën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën e vitit 1999, vetëm e pagave të përfituara në vlerë sa konfirmuar nga ISSH-ja²³.
69. Sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit, për përfshirje në mënyrë të padrejtë të shpenzimeve për ndërtimin e shtëpisë në rrugën “{***}”, në vlerën e 1.063.115 lekëve, trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e fashikullit të çështjes, si dhe kontrolloi vendimin e Komisionit lidhur me këtë çështje, konstatoi se ndryshe nga sa pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni, në analizën e tij financiare të kryer në funksion të verifikimit të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vitin 1999, në zërin “kosto ndërtim objekti te rruga “{***}”, ka vendosur vlerën 354.372 lekë²⁴. Pretendimi i ngritur nga subjekti në ankim, rezultoi t’u referohet gjetjeve fillestare të Komisionit dhe vlerave të zërave të analizës së kryer prej tij në rezultatet e hetimit administrativ. Në këto kushte, trupi gjykues e gjeti të pambështetur në fakte këtë pretendim.
70. Në përfundim të sa më sipër, në shqyrtim të shkakut të ankimit lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues çmoi se me të drejtë Komisioni ka arritur në konkluzionin se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. A. S., ka rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e saj në vitin 1999, por në kushtet kur kjo pasuri është shitur në vitin 2004 dhe të ardhurat e realizuara nga shitja e saj nuk kanë shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie objekt kontrolli, në kuadër të pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, trupi gjykues vlerësoi se konkluzioni i Komisionit lidhur me krijimin e kësaj pasurie nga personi i lidhur, znj. A. S., në vitin 1999, nuk sjell pasoja juridike në vlerësimin e kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.
71. *Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit automjet, të tipit “Mercedes Benz”, vit prodhimi 2000, të blerë në vitin 2013, në vlerën e 400.000 lekëve, për të cilën subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të padrejtë analizën financiare të Komisionit lidhur me krijimin e kësaj pasurie, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
72. Në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni është shprehur në vendim si vijon: *Komisioni, lidhur me këtë pasuri, arriti në përfundimin se:*

²³ Shih vërtetimin e ISSH, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, nr. {***} prot., datë 07.02.2018.

²⁴ Shih tabelën e analizës financiare të Komisionit në faqen 14 të vendimit të këtij të fundit.

- Bazuar në përgjigjet e subjektit dhe provat e paraqitura, Komisioni mori në konsideratë shpjegimet e subjektit lidhur me bursën e përfutur nga vajza, në vlerën 14.000 euro në vit, për vitet 2012 – 2014, dhe këtë vlerë e zbriti nga shpenzimet, si vlera të kryera nga subjekti i rivlerësimit. Rezultoi se subjekti ka sjellë dokumentacion provues lidhur me bursën e studimeve të vajzës, të cilat janë marrë parasysht nga Komisioni dhe janë reflektuar në analizën financiare, por nuk ka provuar shpenzimet dhe kostot e plota të jetesës gjatë periudhës së studimit.

- Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me të ardhurat e bashkëshortes në F. Sh. F. për këtë periudhë.

- Llogaritja e gjendjes së kursimeve cash, në analizën financiare, është bërë nga Komisioni sipas deklarimeve periodike vjetore të bëra nga subjekti dhe të paraqitura në ILDKPKI.

- Subjekti rezultoi në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2013, në shumën prej -564.723 lekësh.

73. Subjekti kundërshtoi si të padrejtë analizën financiare të kryer nga Komisioni lidhur me krijimin e kësaj pasurie, me pretendimin se: (i) janë vlerësuar në mënyrë të padrejtë të ardhurat nga bursa e vajzës së tij, të cilat, sipas subjektit, përfshinin edhe shpenzimet e jetesës dhe akomodimit, të cilat Komisioni ia ka përlllogaritur veçmas; (ii) nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e bashkëshortes së tij nga puna në Dhomën Kombëtare të Zgjidhjes së Konfliktëve pranë F. Sh. F.; si dhe (iii) nuk janë marrë në konsideratë gjendjet e likuiditetit *cash* të deklaruar në vitin paraardhës. Subjekti kundërshtoi si të gabuar edhe mënyrën e kryerjes së analizës financiare për këtë mjet, duke iu referuar momentit të vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve deri në datën e blerjes së automjetit dhe jo në fund të vitit.
74. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të vlerësimit të bursës së studimeve të vajzës së tij, trupi gjykues konstatoi se, referuar vërtetimit të datës 04.02.2020, të lëshuar nga drejtori i Kolegjit {***} Mostar, të dorëzuar nga vetë subjekti i rivlerësimit në mbështetje të shpjegimeve të tij ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, në cilësinë e prindërve të znj. A. H., për dy vitet e saj të shkollimit, gusht 2012 - qershor 2014, pranë këtij kolegji, kanë mbuluar një pjesë të kostos së shkollimit, në vlerën prej 6250 eurosh. Për rrjedhojë, vlerësohet i drejtë qëndrimi i mbajtur nga Komisioni në drejtim të përcaktimit të shpenzimeve për shkollimin e vajzës për vitin 2013 në analizën financiare për këtë vit, si dhe në analizën e kryer për vlerësimin e burimeve të ligjshme të krijimit në këtë vit të pasurisë automjet, të tipit “Mercedes Benz”, vit prodhimi 2000, për sa kohë për shkollimin e vajzës pranë Kolegjit {***} Mostar, subjekti i rivlerësimit provohet të ketë shpenzuar minimalisht vlerën prej 6250 eurosh. Në kuadër të sa më sipër, nga verifikimet e kryera në Kolegj, rezultoi se për periudhën janar – korrik 2013, Komisioni ka përlllogaritur në mënyrë përpjesëtimore, si shpenzim shkollimi për vajzën e subjektit, vlerën prej 196.294 lekësh²⁵, e cila rezultoi të jetë edhe më e ulët nga sa u përlllogarit nga verifikimi i kryer në Kolegj²⁶. Për pasojë, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit u gjet i pabazuar në fakte.
75. Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit sa u takon të ardhurave të pretenduara si të krijuara nga paga e bashkëshortes së tij, si e punësuar në Dhomën Kombëtare të Zgjidhjes së Konfliktëve pranë F. Sh. F., trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi se

²⁵ Shih analizën financiare të pasurisë automjet, tip “Mercedes Benz”, në faqen 15 të vendimit të Komisionit.

²⁶ Në kuadër të verifikimit të saktësisë së përlllogaritjeve të kryera nga Komisioni lidhur me shpenzimet e shkollimit të vajzës së subjektit të rivlerësimit pranë Kolegjit {***} Mostar për vitin 2013 (gjatë periudhës 1 janar deri më 22 korrik që është data e krijimit të kësaj pasurie), u konstatua se ndarja përpjesëtimore e kostos totale të shkollimit për periudhën gusht 2012 - qershor 2014, që i takon periudhës së analizës janar - korrik 2013, u përlllogarit në vlerën e 1814,51 euro, e konvertuar me kursin mesatar vjetor të Bankës së Shqipërisë, në vlerën e 254.507 lekëve.

bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në total, vlerën prej 900.000 lekësh, si të ardhura nga paga si anëtare e Dhomës së Zgjidhjes së Konfliktëve pranë F. Sh. F. për periudhën shtator 2011 – e në vazhdim, ndërsa në deklaratimet periodike pranë ILDKPKI-së, për vitet e mësipërme, deklarimet lidhur me pagën e znj. A. S., i ka bërë subjekti i rivlerësimit, duke i paraqitur ato si vlera totale të cilat u përkisnin të ardhurave të krijuara nga disa burime punësimi, ndër to edhe nga F. Sh. F., për periudhën nga viti 2013. Deklarimin e kryer në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit e ka shoqëruar me vërtetimin nr. {***} prot., datë 19.01.2017, lëshuar nga F. Sh. F., në të cilin përcaktohet: *Vërtetohet se znj. A. S. është anëtare e Dhomës Kombëtare të Zgjidhjes së Konfliktëve pranë F. Sh. F. dhe pagesa e saj që prej periudhës 01.09.2011 ka qenë 20.000 lekë bruto dhe 17.000 neto.*

76. Në kuadër të hetimit të kryer nga ILDKPKI-ja dhe më tej në Komision lidhur me çështjen e të ardhurave të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit si të krijuara nga bashkëshortja e tij, si e punësuar pranë F. Sh. F., rezultoi të jetë administruar sa më poshtë.

76.1. Vërtetimi i datës 14.02.2018, i lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i F. Sh. F. drejtuar ILDKPKI-së, me anë të të cilit deklarohet: *Vërtetohet se znj. A. S. është pjesë e Dhomës Kombëtare të Zgjidhjes së Konfliktëve pranë F. Sh. F.. Pagesa e saj është bërë në bazë të mbledhjeve që DHKZK ka zhvilluar, si anëtare e grupit të DHKZK paguhet në masën 20.000 lekë bruto dhe 18.000 lekë neto. Znj. A. S. për vitin 2011, është paguar [...].*

76.2. Shkresa nr. {***} prot., datë 08.02.2018, e Degës së Arkivit të Rajonit Tiranë pranë ISSH-së, në të cilën, në përgjigje të kërkesës së ILDKPKI-së lidhur me të ardhurat bruto dhe neto të realizuara nga znj. A. S., si pasojë e punësimit të saj pranë Dhomës së Zgjidhjes së Konfliktëve të F. Sh. F., sqarohet se, për periudhën e kërkuar, shtator 2011 – dhjetor 2012, në subjektin “F. Sh. F.”, me dosje {***}, emri i znj. S.nuk figuron. Ndërkohë sa i takon periudhës nga data 2012 e në vijim, për të cilën të dhënat e sigurimeve lidhur me znj. A. S. janë verifikuar nga sistemi informatik i ISSH-së dhe përcjellë pranë ILDKPKI-së me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 11.07.2017, rezulton që për personin e lidhur me subjektin e rivlerësimit, janë derdhur kontribute vetëm nga punëdhënësi Kontrolli i Lartë i Shtetit.

76.3. Gjatë hetimit të kryer nga ana e Komisionit, prej këtij të fundit, me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 06.11.2019, u është kërkuar organeve tatimore përcjellja e të gjitha të dhënave lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore për znj. A. S.. Komisioni ka përcjellë gjithashtu bashkëlidhur kërkesës së saj, edhe vërtetimet e F. Sh. F, me qëllim verifikimin dhe përcjelljen e të ardhurave bruto dhe neto për znj. S., të përfituara nga viti 2011 e në vazhdim.

76.4. Në përgjigje të kësaj shkrese, DPT, me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 13.11.2019, është shprehur: *Në përgjigje të shkresës suaj me nr. {***}, datë 06.11.2019, [...] bashkëlidhur do të gjeni listëpagesat e dorëzuara prej periudhës dhjetor 2011, për shtetasit [...] dhe A. S.. Për sa u përket të ardhurave bruto dhe neto, si dhe tatimit të mbajtur në lidhje me to, prej subjekteve përfituese të shërbimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve sqaron se: DPT administron vetëm regjistrin e tatimpaguesve dhe individëve të regjistruar për Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA). Individët e cituar në shkresën tuaj nuk janë të regjistruar për DIVA, për të mundësuar verifikimin e të ardhurave të kësaj natyre. Pagesa e Tatimit në burim, prej subjekteve të cilat përfitojnë shërbime, bëhet në shumë totale dhe jo e ndarë për secilin prej individëve. Për sa më sipër, Administrata Tatimore nuk mund të verifikojë pagesën e tatimit në burim për individë të veçantë, por një informacion të tillë mund ta kërkontë pranë subjekteve përfituese të shërbimeve.*

77. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se pagesa e përfituar nga znj. A. S. nga F. Sh. F., ka karakterin e një honorari, pagesë e posaçme e përfituar mbi bazë pjesëmarrjeje në mbledhjet e Dhomës Kombëtare të Zgjidhjes së Konfliktëve, dhe jo pagë e përfituar mbi baza të rregullta, sipas një kontrate të mirëfilltë pune. Në këtë kuptim, referuar parashikimeve të legjislacionit të zbatueshëm në fuqi, më konkretisht pikës 2.3.1 të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar²⁷; nenit 8 të ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar²⁸; si dhe pikës 2 të pjesës II të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 77, datë 28.01.2015, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar²⁹, kjo pagesë nuk i nënshtrohet detyrimit për pagesë të kontributeve të detyrueshme për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, për rrjedhojë, në këtë rast, mungesa e të dhënave në databazën e ISSH-së, lidhur me këto pagesa, është në përputhje me ligjin dhe nuk mund të përbëjë provë në drejtim të mosangazhimit të znj. A. S. pranë F. Sh. F., apo se për këto të ardhura nuk janë përmbushur detyrimet e përcaktuara në ligj (kontributet e detyrueshme për sigurime shëndetësore dhe shoqërore). Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se kjo pagesë i nënshtrohet vetëm tatimit mbi të ardhurat personale, i cili duke qenë se buron nga një pagesë jashtë një qendre pune³⁰, sa kohë nuk u vërtetua që znj. A. S. është deklaruar në cilësinë e punëmarrëses pranë F. Sh. F., përlllogaritjet vetëm mbi vlerën bruto të honorarit dhe mbahet në burim nga subjekti tatimpagues F. Sh. F..
78. Në vijim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vlerësoi të pranojë vërtetimin e datës 14.02.2018, të administruar nga F. Sh. F., gjatë hetimit të kryer nga ILDKPKI-ja, si provë të faktit të angazhimit

²⁷ Në udhëzimin e ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i cili detajon përcaktimet e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe përcakton ndër të tjera dhe rregullat për mënyrën e zbatimit të tij, konstatohet se në pikën 2.3.1 të këtij udhëzimi, termi i përdorur në ligj, “shpërblime të tjera”, përkufizohet si: “Të gjitha të ardhurat apo shpërblimet që përfitohen nga rezultatet e punës në vendin e punësimit aktual të individit. Në këtë kategori bëjnë pjesë të ardhurat që merr individi në formë shpërblimi nga fondi i veçantë, apo nga fonde të krijuara me akte të ndryshme ligjore apo statutore të shoqërive, si pagë e 13-të, apo pagesa të ndryshme të kësaj natyre. Në grupin “shpërblime të tjera” përfshihen gjithashtu të ardhura që realizohen nga pjesëmarrja e individit në komisione, komitete, këshilla, borde drejtuese, këshilla mbikëqyrëse etj”. Në po këtë pikë të udhëzimit, sa i takon mënyrës së përlllogaritjes së tatimit mbi këtë kategori të ardhurash personale, përcaktohet shprehimisht: “a) Kur shpërblimi i përfituar për pjesëmarrje në komisione, komitete, këshilla, borde drejtuese, këshilla mbikëqyrëse etj., paguhet jashtë qendrës efektive të punës së individit, këto të ardhura taten në masën 15 për qind²⁷. b) Kur shpërblimi i përfituar për pjesëmarrje në komisione, komitete, këshilla, borde drejtuese, këshilla mbikëqyrëse etj., paguhet në qendrën efektive të punës së individit, këto të ardhura do të taten duke u bashkuar me pagën e muajit përkatës”.

²⁸ Referuar nenit 8 të ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të punëdhënësit për punëmarrësin dhe kontributet e vetë punëmarrësit llogariten sipas nivelit të përcaktuar mbi pagën bruto të punëmarrësit dhe shtesat e tjera me karakter të përhershëm që lindin nga marrëdhëniet e punës, brenda një page bruto minimale dhe nivelit maksimal të pagës, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore, që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. 2. Kontributet e detyrueshme të sigurimit shëndetësor të punëdhënësit për punëmarrësin dhe kontributet e vetë punëmarrësit llogariten sipas nivelit të përcaktuar mbi pagën bruto të punëmarrësit dhe shtesat e tjera me karakter të përhershëm që lindin nga marrëdhëniet e punës, e cila nuk mund të jetë më e vogël nga paga minimale e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”.

²⁹ Në pikën 2 të pjesës II të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 77, datë 28.01.2015, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar, përcaktohet se në pagën bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe sigurimin e kujdesit shëndetësor, nuk përfshihen, ndër të tjera, edhe honorarët apo shpërblimet e tjera të kësaj natyre, që nuk kanë lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës.

³⁰ Shih poshtëshënimin nr. 27, më sipër në vendim.

të znj. A. S. pranë Dhomës Kombëtare të Zgjidhjes së Konfliktëve dhe përfitimit të pagesave për pjesëmarrjen e saj në mbledhjet e kësaj dhome, sipas vlerave të përcaktuara në këtë vërtetim. Këto vlera të konfirmuara nga ILDKPKI-ja nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë me Sekretarin e Përgjithshëm të F. Sh. F., vlerësohen se përmbushin standardin e të ardhurave të ligjshme në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, edhe pse gjatë hetimit administrativ nuk u arrit të provohet nëse është përmbushur apo jo detyrimi i pagesës së tatimit mbi këto të ardhura pranë organit tatimor nga ana e F. Sh. F.. Trupi gjykues e mbështeti këtë konkluzion në komunikimin e sipërcituar me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, sipas të cilit nuk u konfirmua mospagesa nga ana e Federatës e tatimit për të ardhurat për pagesat e përfituara nga znj. A. S., por vetëm u evidentua pamundësia për ta verifikuar këtë fakt, duke qenë se pagesa e tatimit të mbajtur në burim për pagesa të kësaj natyre, bëhet në bllok për të gjithë individët që kualifikohen për një pagesë të tillë dhe se në çdo rast, detyrimi për mbajtjen në burim të vlerës së tatimit, i takonte Federatës. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmoi se vlerat e pagesave të përfituara nga F. Sh. F., si referuar në vërtetimin e datës 14.02.2018, të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i kësaj të fundit, duhet të ishin përfshirë në analizën financiare të viteve përkatëse në zërin e të hyrave dhe rrjedhimisht, edhe në analizën e kryer lidhur me vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë objekt kontrolli.

79. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit në drejtim të metodologjisë së kryerjes së analizës financiare për verifikimin e burimeve të të ardhurave për krijimin e pasurisë automjet, të tipit “Mercedes Benz”, në drejtim të periudhës së vlerësimit të analizës financiare, trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën e Komisionit, arriti në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar. Trupi gjykues e mbështeti këtë konkluzion në arsyetimin logjik se burimet e të ardhurave, të cilat kanë shërbyer në krijimin e një pasurie, vlerësohen dhe përlllogariten si rregull deri në momentin e krijimit të pasurisë dhe jo përtej këtij momenti kohor, pasi logjikisht, çdo e ardhur e krijuar pas krijimit të pasurisë, nuk ka se si të ketë shërbyer për krijimin e saj.
80. Gjithashtu i pabazuar u gjet edhe pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit për përdorimin e gjendjes së akumuluar të *cash*-it të ndodhur në banesë nga viti i mëparshëm, si burim për blerjen e automjetit, për sa kohë një fakt i tillë nuk rezultoi të ishte deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si pakësim i likuiditetit gjendje *cash* në banesë, në kuadër të detyrimeve që u burojnë subjekteve deklaruese pranë ILDKPKI-së, sipas dispozitave të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, dhe as u provua gjatë procesit të rivlerësimit.
81. Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, nga kontrolli i analizës financiare të kryer nga Komisioni lidhur me krijimin në vitin 2013 të pasurisë automjet, të tipit “Mercedes Benz”, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, duke mbajtur në konsideratë konkluzionet e arritura më sipër nga trupi gjykues në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, si dhe disa saktësime lidhur me zërat e tjerë të analizës financiare, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ndodhej në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, për një vlerë prej 381.138 lekësh³¹, krahasuar kjo me vlerën prej 564.723 lekësh të përlllogaritur nga Komisioni.

³¹ Në këtë rezultat ka ndikuar përfshirja në përlllogaritje e të ardhurave nga angazhimi i znj. S. pranë FSHF-së, në vlerën prej 60.300 lekësh, si vlerë takuese për periudhën 01.01.2013 - 22.07.2013, pakësimi i shpenzimeve të përlllogaritura nga Komisioni për shlyerjen e kredisë, në vlerën 231.203 lekë, të cilat, pas verifikimit të kryer në pagesat e kredisë sipas lëvizjeve bankare, rezultuan më të ulëta, si dhe ulja e vlerës së shpenzimeve të jetesës për dy persona, të përlllogaritura në mënyrë përpjesëtimore në vlerën 157.477 lekë, për periudhën e marrë në analizë, nga vlera prej 164.528 lekësh, e përlllogaritur nga Komisioni.

82. Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit automjet, të tipit “Jaguar X Type”, vit prodhimi 2004, të blerë në vitin 2015, në vlerën totale prej 450.000 lekësh (përfshirë detyrimin doganor), për të cilën subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.
83. Në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni është shprehur në vendim si vijon: *Komisioni, lidhur me këtë pasuri, arriti në përfundimin se:*
- *Subjekti nuk arriti të provojë vlerën e saktë të blerjes së këtij automjeti, si dhe ka bërë deklaramit të pasaktë për këtë pasuri.*
 - *Subjekti ka paraqitur një kopje të dokumentit “faturë shitje” të automjetit në Mbretërinë e Bashkuar, sipas të cilit vlera është 2,000 GBP. Subjekti ka pretenduar se kjo faturë është paraqitur edhe më parë prej tij në përgjigje të pyetësorit, e cila është në dosjen e dërguar nga ILDKPKI-ja, si dhe ishte dërguar nga DPSHTRR-ja në Komision. Pas verifikimit nga Komisioni, deklarimi i subjektit nuk rezultoi i vërtetë. Komisioni konstatoi se fatura e shitjes nuk është paraqitur dhe administruar më parë si provë nga Komisioni. Ky dokument i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, nuk konsiderohet si dokument provues sipas legjislacionit shqiptar, pasi është një shkresë e thjeshtë, e përkthyer nga një përkthyes zyrtar dhe noteri konfirmon vetëm nënshkrimin e përkthyesit.*
 - *Bazuar në këtë faturë, rezultoi që shitësi i ka shitur subjektin të rivlerësimit në Mbretërinë e Bashkuar, në datën 12.8.2015, këtë automjet. Sipas të dhënave të sistemit TIMS dhe deklaramit të subjektit në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, rezultoi se në këtë datë (12.8.2015), subjekti i rivlerësimit ishte me pushime në Antalia, Turqi, dhe jo në Mbretërinë e Bashkuar, ku pretendon se ka qenë si palë për blerjen e këtij automjeti.*
 - *Subjekti paraqiti dokumentacion provues lidhur me bursën e studimeve të vajzës.*
 - *Bazuar në përgjigjet e subjektit dhe provat e paraqitura, Komisioni mori në konsideratë shpjegimet lidhur me bursën e përfituar nga vajza, në vlerën 181.478 USD, për periudhën 2014 – 2016 dhe këtë vlerë e zbriti nga shpenzimet si vlera të kryera nga subjekti i rivlerësimit. Rezultoi se subjekti ka sjellë dokumentacion provues lidhur me bursën e studimeve të vajzës, të cilat janë marrë parasysh nga Komisioni dhe janë reflektuar në analizën financiare.*
 - *Subjekti rezultoi në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie, në shumën prej -275.596 lekësh.*
84. Subjekti pretendoi se Komisioni në trajtimin e kësaj pasurie, ka shtrembëruar faktet. Sipas subjektit të rivlerësimit, ai në asnjë rast nuk ka pretenduar të ketë qenë personalisht në Angli, në momentin e nënshkrimit të kontratës për blerjen e automjetit. Sipas subjektit të rivlerësimit, legjislacioni anglez e njuh të drejtën e regjistrimit të mjetit në emër të blerësit edhe pa qenë blerësi prezent. Subjekti pretendoi gjithashtu se Komisioni qëllimisht i ka llogaritur një pjesë shpenzimesh për shkollimin e vajzës në ShBA, në vlerën e 450.000 lekëve për 9 muaj, në vitin 2015, ndërkohë që sipas tij, bursa e vajzës përfshinte të gjitha shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit.
85. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit lidhur me kontrollin e ushtruar mbi krijimin e pasurisë së luajtshme të llojit automjet, tipi “Jaguar X Type”, vit prodhimi 2004, konstatoi si më poshtë.
86. Në kuadër të hetimeve të kryera nga ana e ILDKPKI-së dhe Komisionit lidhur me kontrollin për krijimin e kësaj pasurie, është administruar dosja e këtij automjeti nga DPSHTRR-ja, nga e cila u konstatua se nuk bënte pjesë kontrata e shitblerjes së automjetit nga subjekti i rivlerësimit apo fatura tatimore lidhur me këtë transaksion shitblerjeje, ndonëse këto janë dokumente të

detyrueshme për efekt të regjistrimit të mjetit (në rastin konkret regjistrim për herë të parë) pranë regjistrimit kombëtar të automjeteve.

87. Gjatë procedurës së hetimit administrativ në Komision, subjekti është pyetur në pyetësorin e datës 14.02.2019, lidhur me kontratën e shitblerjes së automjetit dhe në përgjigjet e depozituara në Komision, në datën 28.02.2019, është përgjigjur: *Autoveturën tip “Jaguar”, viti i prodhimit 2004, me ngjyrë të zezë, me targa {***}, e kam sjellë nga Britania e Madhe për përdorim familjar, në vlerën 2.000 paund. Theksoj edhe një herë se vlera e këtij automjeti pas pagesës së doganës, dokumentacionit dhe targimit me targa {***}, arrin në shumën 450.000 lekë. Bashkëngjitur: “New and used vehicle sales invoice” e datës 2 gusht 2015 (dokumenti i blerjes së autoveturës tip “Jaguar”, viti i prodhimit 2004, me ngjyrë të zezë, me targa {***}, në shumën 2000 paund); dokumentacioni i plotë i mjetit.* Subjekti në vijim, gjatë seancës dëgjimore, ka depozituar kopjen origjinale të faturës së pretenduar të shitblerjes së automjetit dhe një formular V5C/3.
88. Në analizë të sa më sipër, konstatohet se më të drejtë subjekti pretendoi të ketë depozituar një faturë për shitblerjen e automjetit në vlerën e 2.000 £ dhe ky akt është administruar nga Komisioni që në fazën e dërgimit të pyetësorëve të ndryshëm subjektit të rivlerësimit dhe është për rrjedhojë, pjesë e fashikullit të çështjes në formën e tij origjinale dhe si fotokopje. Për pasojë sa shprehur nga ana e Komisionit në vendim, si referuar në paragrafin 83 më sipër, rezultoi të mos pasqyrojë në mënyrë korrekte këto fakte në drejtim të hetimit lidhur me këtë çështje.
89. Ndodhur në këto kushte, trupi gjykues pranoi faturën e dorëzuar nga ana e subjektit të rivlerësimit si provë të faktit se vlera e investuar për blerjen e automjetit, të tipit “Jaguar X Type”, në vitin 2015, është 2000 £ (pa përfshirë këtu shpenzimet e transportit të automjetit nga Mbretëria e Bashkuar). Gjithashtu, edhe nga shqyrtimi i deklaratës doganore të datës 14.10.2015, trupi gjykues konstatoi se ndonëse për shkak të cilësisë së shkrimit është e pamundur të verifikohet shuma totale e faturuar (pasqyruar në rubrikën nr. 22 të deklaratës), vlera statistikore e automjetit, e cila ka shërbyer edhe në drejtim të përlllogaritjes së vlerës së detyrimit doganor, është pasqyruar në rubrikën nr. 46 të deklaratës së sipërcituar, në vlerën e 366.81... lekëve (shifra e fundit është e palexueshme), vlerë kjo e përafërt me vlerën e faturës së dorëzuar nga ana e subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues e gjeti kontradiktor arsyetimin e Komisionit, i cili, ndonëse është shprehur: *Ky dokument i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, nuk konsiderohet si dokument provues sipas legjislacionit shqiptar – duke iu referuar faturës së shitjes së automjetit, dhe për më tepër duke vënë në dyshim vërtetësinë e saj edhe në drejtim të faktit se në datën e lëshimit të faturës, subjekti nuk mund të ketë qenë prezent në territorin e Britanisë së Madhe, në analizën financiare të kryer për efekt të vlerësimit të burimeve të ligjshme për blerjen e këtij automjeti, ka përlllogaritur si kosto blerjeje vlerën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, 450.000 lekë, e cila është përlllogaritur prej këtij të fundit mbi bazën e çmimit të blerjes prej 2.000 £.*
90. Sa i takon shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me analizën financiare të kryer nga Komisioni për verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, nga verifikimi i kryer nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, në zërat e analizës financiare rezultoi se për periudhën e marrë në analizë, 01.01.2015 - 20.10.2015, u përlllogaritën: (i) të ardhurat nga paga e subjektit për këtë vit, sipas kalimeve të pagave në lëvizjet bankare pranë Bankës Tirana, të cilat në vlerë totale rezultuan më të larta se ato të përlllogaritura nga Komisioni; (ii) të ardhurat nga angazhimi i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit pranë F. Sh. F., në vlerën prej 4.500 lekësh, të cilat nuk ishin përfshirë në llogaritjet e kryera nga Komisioni; (iii) shpenzimet për shkollimin e vajzës së subjektit, rezultuan në vlerën 472.353 lekë, më të ulëta nga përlllogaritja e Komisionit, duke iu referuar kursit zyrtar mesatar vjetor nga Banka e Shqipërisë për vitin e marrë

në analizë; si dhe (iv) në ndryshim nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, u morën në konsideratë në këtë analizë likuiditetet e pakësuara në bankë për periudhën 01.01.2015 - 20.10.2015, në shumën 220.054 lekë. Në përfundim, pas përlogaritjes së të ardhurave dhe shpenzimeve të korigjuara si më sipër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e këtij automjeti në vitin 2015.

91. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues e gjeti të drejtë dhe të bazuar shkaku e ngritur në ankim lidhur me kontrollin e kësaj pasurie dhe, rrjedhimisht, vlerësoi se vendimi i Komisionit lidhur me këtë pasuri, është i pabazuar në fakte.
92. *Lidhur me konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore për vitet 2004 - 2016, gjendjen e llogarive bankare të bashkëshortes dhe ndryshimet (shënotat dhe pakësimet) në fund të secilit vit përkatës, detyrim ky që rrjedh nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, subjekti i rivlerësimit ka prapësuar se, referuar parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, ai nuk ka pasur asnjëherë detyrimin të deklarojë nëpër deklaratat periodike vjetore, gjendjet e llogarive bankare të bashkëshortes së tij dhe se ka menduar që formulari në çdo rast është plotësuar në mënyrë të rregullt nga ana e saj.*
93. Në shqyrtim të sa më sipër, referuar parashikimeve të legjislacionit të zbatueshëm lidhur me deklarimin e pasurive dhe interesave privatë pranë ILDKPKI-së, trupi gjykues e gjeti të pabazuar në ligj këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit. Referuar parashikimeve të nenit 21 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar: *Deklarimi i pasurive, i burimeve të tyre, i detyrimeve financiare bëhet sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe në formën e përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm. Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit. Deklarimi duhet të përmbajë edhe faktin nëse deklaruesi/ja ka ose jo persona të tjerë të lidhur. Në kuptim të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e tij si subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së, mban përgjegjësi për deklarimin e tij, i cili përfshin ndër të tjera edhe deklarimin e personit të lidhur me të. Verifikimi i përmbushjes së këtij detyrimi ligjor është përgjegjësi e subjekteve deklaruese.*
94. Megjithatë, pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi që këto parregullsi në deklaratat periodike të subjektit të rivlerësimit, nuk paraqesin relevancë në konkluzionin lidhur me saktësinë e deklaratave të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, në kuadër të procesit të rivlerësimit dhe se efektet e këtyre parregullsive do të mbahen në konsideratë në kuadër të analizës financiare të viteve gjatë të cilave mund të kenë rezultuar me shtim të pajustificuar të likuiditeteve bankare.
95. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament”, me sip. 106 m², me nr. pasurie {***}, ZK {***}, rruga “{***}”, pall. {***}, shk. {***}, Tiranë, për të cilën subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
96. Në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaratave dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni është shprehur në vendim si vijon: *Komisioni, lidhur me këtë pasuri, arriti në përfundimin se:*
- *Subjekti deklaroi që çmimi i vendosur në kontratë për blerjen e apartamentit, është favorizues. Këtë fakt, subjekti e arsyeoi me pretendimin se janë kryer disa veprime juridike, të cilat janë finalizuar me dy kontrata shitblerjeje pasurie të paluajtshme dhe një transaksion bankar.*

- Subjekti pranoi se vlera e kontraktuar për apartamentin në rr. “{***}”, nuk është vlera reale e tij.

- Deklarimet e subjektit për shkëmbim të pasurive, nuk janë provuar me dokumentacion shkresor. Rezultoi se për të tria pasuritë e deklaruar si të shkëmbyera, nuk provohen veprimet juridike, të kryera konform legjislacionit shqiptar, por secila nga këto pasuri është finalizuar përmes kontratave të shitblerjes, ku përcaktohen edhe vlerat e blerjeve përkatëse.

- Subjekti nuk vërtetoi të ardhurat e pretenduara të bashkëshortes nga punësimi te gazeta “{***}”.

- Subjekti nuk vërtetoi të ardhura të ligjshme nga aktiviteti “{***}”, të cilat subjekti i pretendoi si burim për shlyerjen e kredisë tek UBA. Këto të ardhura, subjekti nuk i ka deklaruar as në deklaratat periodike vjetore të paraqitura në ILDKPKI, as në deklaratën “vetting”.

- Subjekti rezultoi në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në shumën prej -5.054.904 lekësh.

- Në analizën financiare të kësaj pasurie, është marrë parasysh edhe vlera e deklaruar dhe vërtetuar me vërtetimin e shoqërisë “{***}” për pagesën e këstit të apartamentit në rr. “{***}”, në vlerën prej 700.000 lekësh. Vlera përpjesëtimore që u takon pesë muajve të parë të vitit, u është shtuar shpenzimeve të bëra para blerjes së pasurisë nga subjekti, me adresë në rr. “{***}”.

97. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit për çmim favorizues në blerjen e apartamentit, me pretendimin se kjo gjë ka ndodhur si pasojë e faktit që shitësi i kësaj pasurie është njëkohësisht edhe blerësi i pasurisë së paluajtshme të llojit “dyqan” në rr. “{***}”, Tiranë, në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

98. Subjekti kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit për pamundësi financiare në krijimin e kësaj pasurie, me pretendimin se në analizën financiare të Komisionit janë përfshirë gabimisht shpenzime që nuk i takojnë subjektit të rivlerësimit, si dhe nuk janë përfshirë disa zëra të ardhurash. Këtë shkak të ankimit, subjekti e mbështet në sa më poshtë.

98.1. Shlyerja e kredisë pranë UBA Bank, në vlerën prej 4.705.190 lekësh, është pasqyruar dhe përlllogaritur si shpenzim i subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që sipas këtij të fundit, kjo kredi është shlyer nga blerësi i dyqanit dhe njëkohësisht shitësi i apartamentit, z. F. V..

98.2. Janë përlllogaritur në mënyrë të padrejtë dhe të pambështetur në prova, shpenzimet në vlerën e 869.821 lekëve, si kosto ndërtimi për shtëpinë në rrugën “{***}”, të cilat nuk janë kryer në atë vit.

98.3. Nuk është mbajtur në konsideratë fakti se lokali ka qenë në aktivitet dhe krijonte të ardhura, fakt ky të cilin subjekti e mbështeti në disa fatura që vërtetojnë pagimin e taksave në atë periudhë.

98.4. Të ardhurat e bashkëshortes nga pagat janë llogaritur vetëm mbi bazën e të dhënave të sigurimeve shoqërore dhe jo sipas vlerës së tyre në vërtetimin e punëdhënësit nr. {***}, datë 19.01.2017, në masën 150.000 lekë në muaj, për periudhën e viteve 1998 - 2005. Në drejtim të përlllogaritjes së të ardhurave nga paga e bashkëshortes, subjekti i rivlerësimit pretendoi se mosruajtja e dokumentacionit nga ana e punëdhënësit, kur një fakt i tillë pohohet prej tij, nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi bashkëshorten e tij dhe aq më pak subjektin e rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni ka mbajtur standarde të dyfishta në vlerësimin e çështjes së të ardhurave nga punësimi.

99. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi sa më poshtë.

99.1. Në datën 22.05.2003, përpara noterit A. R., është lidhur një kontratë noteriale shitjeje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., mes z. F. V. në cilësinë e shitësit dhe znj. A. S. në cilësinë e blerësit të pasurisë së paluajtshme “apartament”, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 106 m², me adresë në rr “{***}”, Tiranë. Sipas pikës 3 të kësaj kontrate: *Blerësi i paguan shitësit një shumë prej 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekësh. Kjo shumë paguhet me nënshkrimin e kësaj kontrate.*

99.2. Në datën 21.05.2003 përpara të njëjtit noter z. A. R. është lidhur një kontratë noteriale shitjeje për pasuri të paluajtshme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., mes z. Skënder Haluci në cilësinë e shitësit dhe z. F. V. në cilësinë e blerësit dhe objekt shitblerjen e një dyqani me sipërfaqe të përgjithshme prej 95.5 m², me adresë në Rr “{***}”, Tiranë. Referuar nenit 3 të kësaj kontrate: *Blerësi i paguan shitësit një shumë prej 1.900.000 (një milion e nëntëqind mijë) lekë. Kjo shumë paguhet me nënshkrimin e kësaj kontrate.*

99.3. Në datën 22.05.2003, para noteres L. Gj., është lëshuar një deklaratë noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., nga Banka Arabe Shqiptare Islamike, e përfaqësuar nga z. E. S. dhe z. A. Sh., sipas së cilës: *Nga gjithë sa më sipër, në cilësinë e përfaqësuesve të Bankës Arabe Shqiptare Islamike ShA, deklarojmë se huaja e marrë nga ana e huamarrësit, është shlyer dhe pasuria e përshkruar më lart lirohet nga hipoteka.*

99.4. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së kredisë pranë kësaj banke, rezultoi se në datën 22.05.2003, është kryer një depozitim në *cash*, në vlerën e 34.965 USD nga z. F. V., me përshkrimin: *Pagesë për blerjen e dyqanit që është në pronësi të Skënder Halucit.*

100. Në analizë të sa më sipër konstatuar, në vlerësimin e trupit gjykues, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, arrihet të provohet fakti se transaksionet e shitblerjes së pasurive janë të lidhura dhe mbi të gjitha provohet fakti se shlyerja e kredisë pranë bankës UBA, është kryer nga z. V.. Kjo mënyrë të vepruari me kontrata të veçanta shitblerjeje, duke kompensuar një pjesë të vlerave të pasurive si pasojë e këmbimit të tyre, dhe mbi të gjitha duke mos përfshirë në vlerën e shitjes së dyqanit pagesën e kryer nga F. V. për shlyerjen e kredisë (ndonëse përshkrimi është i qartë që kjo shumë monetare është pjesë e çmimit të dyqanit), krijon dyshime të arsyeshme në drejtim të një vullneti të palëve për t’iu shmangur detyrimeve tatimore lidhur me kalimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme, ku, referuar parashikimeve të legjislacionit të kohës, tatimi përcaktohej si përqindje e vlerës në shitje të pasurisë. Në këtë kontekst, në kuadër të procesit të rivlerësimit, vlera e paguar nga z. V., në vlerësim të trupit gjykues, duhet të ishte trajtuar si pjesë e çmimit të shitjes së dyqanit në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, duhet t’i ishte nënshtruar standardit të të ardhurave të ligjshme, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Në të kundërt, në rast të trajtimit të kësaj pagese të shkëputur nga transaksioni i shitblerjes së dyqanit në rrugën “{***}”, Komisioni duhet t’ia kishte nënshtruar këtë pagesë zbatimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, dhe ta kualifikonte z. F. V., si person tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të kësaj dispozite ligjore, dhe konkluzionin lidhur me shlyerjen e kredisë, do duhej ta bazonte në konkluzionin e një analize në kuadër të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe jo të qëndrimit që shlyerja e kredisë është kryer nga subjekti i rivlerësimit, sa kohë një konkluzion i tillë u provua i pabazuar në fakte.

101. Sa i takon verifikimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në drejtim të analizës financiare lidhur me burimet e ligjshme për krijimin e pasurisë së paluajtshme, apartament me sip. 106 m², në rr. “{***}”, si burim i së cilës janë deklaruar vetëm të ardhurat personale nga paga të personit të lidhur, znj. A. S., trupi gjykues – pasi kontrolloi analizën e kryer nga Komisioni lidhur me krijimin e kësaj pasurie, duke mbajtur në konsideratë dhe duke pasqyruar në zërat e analizës së

Komisionit konkluzionet e arritura më sipër në vendim, lidhur me (i) vlerësimin e të ardhurave të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* nga znj. A. S., si të realizuara nga punësimi pranë gazetës “{***}”; (ii) konkluzionet lidhur me vlerën e shpenzimeve të kryera si kosto ndërtimi për shtëpinë në rrugën “{***}”; dhe (iii) konkluzionin e arritur nga trupi gjykues më sipër, se shlyerja e kredisë pranë Bankës UBA është kryer nga z. V. dhe jo nga subjekti i rivlerësimit, por edhe të faktit se kjo pagesë është pjesë e çmimit të shitjes së dyqanit në rrugën “{***}” – arriti në përfundimin se për këtë pasuri të blerë në vitin 2003, me vlerë 1.600.000 lekë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, A.S., rezultuan me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

102. Kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me mospërfshirjen në analizën e Komisionit të të ardhurave të pretenduara nga aktiviteti privat i bar-kafesë “{***}”, person fizik, u gjetën të pabazuara në fakte pasi subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se arriti të provojë faktin që personi fizik A. S. ka ushtruar aktivitet privat (bar-kafe), referuar 2 mandateve të arkëtimeve të datave 06.08.2002 dhe 05.09.2002, njëri lidhur me pagesën e tatimit fiks për një periudhë 5-mujore dhe tjetri lidhur me pagesën e një takse “solidariteti” për muajin shtator 2002, nuk arriti të provojë xhiron e krijuar për vitet 2002 dhe 2003 dhe aq më pak fitimet e krijuara nga ky aktivitet privat për këtë periudhë.
103. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “bar-kafe”, me sip. 65 m², me adresë në rrugën “{***}”, Tiranë, të shitur në vitin 2003, për të cilën subjekti i rivlerësimit pretendoi se analiza e Komisionit lidhur me krijimin e kësaj pasurie, është e gabuar, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes lidhur me krijimin e saj, konstatoi si më poshtë.
104. Në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni është shprehur në vendim si vijon: Komisioni, lidhur me këtë pasuri, arriti në përfundim se:
- Subjekti nuk vërtetoi me dokumentacion të ardhurat e pretenduara të bashkëshortes nga punëdhënësi, gazeta “{***}”, për periudhën e blerjes së pasurisë.
 - Subjekti nuk vërtetoi ligjshmërinë e pagesës së kredisë tek UBA, nga shtetasi F. V..
 - Subjekti pranoi se vlera e shitjes së kësaj pasurie nuk është 1.900.000 lekë, sipas kontratës, por mbi këtë vlerë duhet shtuar edhe vlera e shlyerjes së kredisë tek UBA, 34.965 USD nga F. V.. Përveç kësaj, këtu pretendoi edhe blerjen me çmim më të ulët të pasurisë në rr. “{***}”, në vlerën 1.600.000 lekë.
 - Llogaritja e kostos së ndërtimit është bërë për periudhën 1997 – 2005 (sipas deklarimeve të subjektit në pyetësor) për 1/3 e sipërfaqes së plotë të ndërtimit, bazuar kjo në bindjen e krijuar nga Komisioni. Në analizën financiare është përfshirë vlera e 1/3-tës së sipërfaqes totale të ndërtimit, sipas deklaramit të subjektit.
 - Subjekti rezultoi në mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e pasurisë në vitin 1998, në vlerën -8.876.115 lekë.
105. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar analizën financiare të kryer nga Komisioni, lidhur me pamundësinë financiare për krijimin me burime të ligjshme të kësaj pasurie në vitin 1998, me pretendimin se në këtë analizë, Komisioni ka përfshirë në mënyrë të padrejtë:
- 105.1. shlyerjen e kredisë tek UBA Bank, në masën e 4.705.190 lekëve, si shpenzim të kryer nga subjekti i rivlerësimit, ndërkohë që sipas subjektit të rivlerësimit, ky veprim bankar është kryer nga z. F. V.. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit referoi ekstraktin e llogarisë

së kredisë të lëshuar në datën 07.02.2020, si dhe një deklaratë noteriale të z. F. V., i cili konfirmoi këtë marrëdhënie mes tij dhe subjektit të rivlerësimit;

105.2. shumën prej 60.000 eurosh, si shpenzim për likuidimin e çmimit të lokalit, ndërkohë që ky likuidim është bërë me kredinë e marrë në vitin 2002, ndërsa vetë kredia është likuiduar në vitin 2003, pjesërisht nga të ardhurat e lokalit dhe pjesa e mbetur nga blerësi F. V.;

105.3. vlerën prej 2.319.523 lekësh, si shpenzim për ndërtim shtëpie në rrugën “{***}”, kur sipas subjektit të rivlerësimit, e gjithë vlera e shpenzuar për ndërtimin e kësaj shtëpie, nuk e kalon vlerën e 2.000.000 lekëve.

- 106.** Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues në vijim edhe të analizës dhe konkluzioneve të arritura nga shqyrtimi i shkakut të ankimit lidhur me *pasurinë e paluajtshme, të llojit “apartament” me sip. 106 m², në rrugën “{***}”, Tiranë*, konstatoi fillimisht se konkluzioni i Komisionit është jo i qartë. Komisioni lidhur me këtë pasuri, ka trajtuar fillimisht momentin e shitjes së saj në vitin 2003, duke evidentuar problematikat në drejtim të marrëdhënies së krijuar mes subjektit të rivlerësimit dhe z. V. dhe në vazhdim është shprehur edhe në lidhje me pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie në vitin 1998, ndërkohë që në vlerësim të trupit gjykues, analiza dhe arsyetimi i Komisionit në drejtim të kontrollit të ushtruar ndaj kësaj pasurie, duhet të niste me verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të saj në vitin 1998 dhe, në vijim, të vlerësohej mënyra e shitjes së saj dhe të ardhurat e krijuara nga tjetërsimi i kësaj pasurie, të cilat vlerësimin e ligjshmërisë së tyre e kanë të lidhur në mënyrë të pashmangshme me vlerësimin mbi ligjshmërinë e krijimit të pasurisë në vitin 1998.
- 107.** Lidhur me pretendimet e subjektit në drejtim të analizës financiare të kryer për efekt të vlerësimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë objekt kontrolli, “bar-kafe” me sip. 65 m², me adresë në rrugën “{***}”, Tiranë, në vitin 1998, trupi gjykues konstatoi se pasuria objekt kontrolli rezultoi të jetë blerë nga subjekti i rivlerësimit me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., të lidhur përpara noteres L. K., në datën 30.12.1998. Sipas kësaj kontrate, palët kanë rënë dakord: *Shitësi i mësipërm deklaroi se këtë dyqan, me truallin që i takon, ia shet blerësit kundrejt shumës 60.000 USD, shumë e cila është paguar jashtë kësaj zyre nga blerësi dhe shitësi nuk paraqet pretendime për to.*
- 108.** Ndërkohë, referuar të dhënave të administruara në fashikullin e çështjes nga Banka UBA, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka përfituar nga kjo bankë kredinë në vlerën e 50.000 USD, në llogarinë e tij bankare, në datën 01.02.2002 dhe, në vazhdim, deri në datën 22.05.2003, subjekti rezultoi se ka paguar rregullisht këstet e kredisë pranë kësaj banke, në shumën e 1.665 USD në muaj. Në vijim, në datën 22.05.2003, në llogarinë e subjektit të rivlerësimit pranë së njëjtës bankë, është depozituar nga z. F. V. shuma prej 34.965 USD, me përshkrimin: “MR. F. V. – Pagesë për blerjen e dyqanit që është në pronësi të Skënder Halucit”. Kjo vlerë është debituar (mbajtur) në të njëjtën datë nga banka, duke shlyer në këtë mënyrë pjesën e mbetur të detyrimit që subjekti ka pasur ndaj saj, lidhur me kredinë e marrë nga subjekti i rivlerësimit në datën 01.02.2002.
- 109.** Në vijim, në analizë të sa më sipër konstatuar, në konsideratë edhe të parashikimeve të nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile³², trupi gjykues e gjen të pabazuar në fakte pretendimin e subjektit të rivlerësimit se çmimi i blerjes së kësaj pasurie prej 60.000 USD, është mbuluar me kredinë e

³² Në nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile, përcaktohet: “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre, për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre, ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”.

marrë në vitin 2002, në vlerën e 50.000 USD, në kushtet kur rezultoi e provuar se sipas parashikimit në kontratë, çmimi i shitblerjes, prej 60.000 USD, rezultoi të ketë qenë i paguar jashtë zyrës noteriale para datës së lidhjes së kontratës. Në vijim të këtij konkluzioni, edhe pretendimet në lidhje me shlyerjen e kredisë prej z. V., çmohen pa efekt në lidhje me analizën e burimeve të krijimit të pasurisë objekt kontrolli, sa kohë kredia e marrë në vitin 2002, me të drejtë nuk është vlerësuar nga Komisioni si burim për krijimin e saj.

110. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke mbajtur në konsideratë përfundimet e paragrafit të mësipërm, si dhe ato lidhur me konkluzionet e arritura më sipër në vendim lidhur me vlerën e shpenzimeve për ndërtimin e “apartamentit papafingo”, me sip. 242 m², në rrugën “{***}”, e gjen të drejtë dhe të bazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri. Ndërsa sa u takon pretendimeve të ngritura lidhur me shitjen e kësaj pasurie, z. F. V., në vitin 2003, referojuni analizës së kryer më sipër në vendim, lidhur me shqyrtimin e shkakut të ankimit dhe konkluzioneve të arritura³³ për blerjen në po të njëjtin vit nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, të apartamentit me sip. 106 m², të pretenduar si blerje në funksion të shitjes së dyqanit (pasurisë objekt kontrolli, “bar-kafe” me sip. 65m², në rrugën “{***}”, Tiranë).
111. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament” me sip. 65 m², me adresë në rrugën “{***}”, Tiranë, blerë me kontratë sipërmarrjeje në vitin 2000, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
112. Në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni është shprehur në vendim si vijon: *Komisioni, lidhur me këtë pasuri, arriti në përfundim se:*
- *Subjekti pranoi pasaktësinë në deklaramit lidhur me vlerën e apartamentit (27.000 USD/ 3.000.000 lekë), me pretendimin e mungesës së dokumenteve në momentin e deklaramit periodik në vitin 2004, ndonëse kontrata e sipërmarrjes është lidhur në vitin 2000.*
 - *Subjekti nuk provoi me dokumentacion shkresor se kredinë e marrë te Banka Amerikane në vitin 2004, e ka përdorur si burim për blerjen e këtij apartamenti.*
 - *Subjekti nuk paraqiti dokumentacion bindës nga shoqëria ndërtuese “{***}” për vërtetimin e kohës së pagesës të vlerës së blerjes së apartamentit. Bazuar në vërtetimin e parë të shoqërisë “{***}”, pagesa është shlyer krejtësisht deri në vitin 2003. Sipas vërtetimit të sjellë, në përgjigje të rezultateve të hetimit, shoqëria ndërtimore konfirmon se shlyerja e vlerës së apartamentit shtrihet në periudhën 2000 – 2004. Pra, rezultuan dy vërtetime të ndryshme lidhur me periudhën e shlyerjes së detyrimit për këtë pasuri.*
 - *Subjekti pretendon se me kredinë e marrë te Banka Amerikane, ka kryer edhe shpenzime mobilimi të apartamentit, por pa paraqitur dokumentacion provues. Megjithatë, lidhur me këto shpenzime, Komisioni mori në konsideratë përgjigjet e subjektit dhe i pasqyroj në analizën financiare.*
 - *Subjekti rezultoi në mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e kësaj pasurie gjatë viteve 2000, 2001, 2003 dhe 2004, përkatësisht në vlerat -1.823.612 lekë, -1.281.105 lekë, - 5.718.823 lekë, dhe -947.158 lekë. Në total, pamundësia financiare arrin një vlerë prej -9.770.698 lekësh.*
113. Në ankimin e tij, subjekti i rivlerësimit, pasi ka renditur konkluzionet e arritura nga Komisioni si më sipër referuar, është shprehur se ka ngritur në Komision pretendimet si më poshtë vijojnë.

³³ Shih analizën në paragrafët 100 e vijues, më sipër në këtë vendim.

113.1. Diferenca e konstatuar në vlerat e deklaruara të pasurisë nga ana e Komisionit, është e drejtë dhe ka ardhur si rrjedhojë e faktit se në vitin 2004, deklarimi i vlerës së apartamentit është thënë me përafërsi bazuar në deklaratimet e bashkëshortes pasi, sipas subjektit, ai nuk e ka pasur në dispozicion kontratën e sipërmarrjes, ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting*, deklarimi është kryer nga bashkëshortja bazuar në përmbajtjen e kontratës.

113.2. Konkluzioni i Komisionit, lidhur me veprimet e kryera dhe destinacionin e kredisë së marrë në vitin 2004 pranë Bankës Intesa San Paolo, sipas subjektit të rivlerësimit, është i gabuar, pasi sipas këtij të fundit, destinacioni i saj ka qenë pikërisht shlyerja e pjesës së mbetur të vlerës së apartamentit, pasi 1.000.000 lekë ishin shlyer nga bashkëshortja në momentin e lidhjes së kontratës dhe pjesa tjetër sipas vërtetimit të lëshuar nga shoqëria “TID” ShPK.

113.3. Subjekti ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit për shmangien e pagimit të detyrimeve tatimore, si pasojë e mosregjistrimit të pasurisë në ZVRPP, si konkluzion të pabazuar, duke pretenduar që regjistrimi i kësaj pasurie nuk është realizuar si pasojë e mosregjistrimit të objektit nga firma ndërtuese dhe jo për faj të subjektit të rivlerësimit.

113.4. Subjekti ka kundërshtuar edhe analizën financiare të kryer nga Komisioni lidhur me verifikimin e mundësisë financiare për krijimin e kësaj pasurie dhe ka pretenduar se përllogaritjet e Komisionit nuk janë bërë në mënyrë korrekte, pasi nuk janë përllogaritur të ardhurat, nuk janë marrë në konsideratë kreditë, si dhe dokumentacioni i paraqitur nga bankat dhe firmat ndërtuese. Subjekti kundërshtoi edhe vlerën e përllogaritur si shpenzime për shkollimin e vajzës me të njëjtin argument se bursa ka përfshirë edhe kostot e jetesës, edhe ato të akomodimit.

114. Nga shqyrtimi i pretendimeve të subjektit të rivlerësimit si më sipër referuar, paragrafi 113, pikat “a” – “c”, vlerësuar këto në raport edhe me rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, si dhe me shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit ndaj këtyre rezultateve, trupi gjykues konstatoi se pretendimet e sipërcituara, të parashtruara në ankimin e subjektit të rivlerësimit, përfaqësojnë qëndrimin e subjektit të rivlerësimit ndaj gjetjeve të Komisionit në fazën e mbylljes së hetimit për kriterin e pasurisë³⁴, qëndrim ky për të cilin Komisioni rezultoi të jetë shprehur në vendimin e tij dhe mbi bazën e të cilit ka arritur në konkluzionet e parashtruara në paragrafin 112, më sipër në këtë vendim, lidhur me këtë pasuri. Trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, përveç përsëritjes së pretendimeve të ngritura përpara Komisionit dhe të shqyrtuara e arsyetuara prej tij, nuk ngre ndonjë shkak të ri për cenimin e kësaj vendimmarrjeje, e cila, pas kontrollit të ushtruar nga trupi gjykues, rezultoi të jetë marrë në zbatim të drejtë të ligjit mbi situatën faktike të konstatuar në mënyrë të saktë dhe të plotë nga ana e Komisionit në vendim.

115. Sa i takon saktësisë së rezultatit financiar të analizës së kryer nga Komisioni, trupi gjykues, pasi kontrolloi përllogaritjet e kryera prej tij, në konsideratë edhe të konkluzioneve të arritura më sipër në këtë vendim, pasi bëri edhe reflektimet e nevojshme³⁵, arriti në konkluzionin se për pasurinë e

³⁴ Trupi gjykues konstaton gjithashtu se një pjesë e gjetjeve fillestare të Komisionit lidhur me dyshimin për shmangie të detyrimeve tatimore, si pasojë e mosregjistrimit të pasurisë në ZVRPP, nuk janë kualifikuar si konkluzione përfundimtare lidhur me vlerësimin e pasurisë objekt kontrolli.

³⁵ Në analizën financiare pjesore për vitin 2000, u përllogaritën në mënyrë proporcionale më tepër të ardhura nga puna e subjektit nga sa ka përllogaritur Komisioni për 10 muaj.

- Në analizën financiare të kryer për vitin 2003, u përllogaritën vetëm shpenzimet e shlyerjes së kredisë deri në datën e shlyerjes dhe mbylljes së kredisë pranë Bankës UBA, pa përfshirë në përllogaritje vlerën e kredisë së shlyer nga shtetasi F. V..
- Kostoja e ndërtimit të objektit 3-katësh në rr. “[***]” u përllogaritur në vlerë më të ulët se Komisioni, në shumën 590.310 lekë, në mënyrë proporcionale për 10 muaj në vitin 2000; 708.371 lekë, kostoja e ndërtimit të objektit 3-

paluajtshme të llojit “apartament”, me sipërfaqe 65 m², me adresë në rrugën “{***}”, në Tiranë, të porositur me çmimin prej 3.000.000 lekësh, sipas kontratës së sipërmarrjes të vitit 2000, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, A. S., rezultuan me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, në vlerën e 7.035.447 lekëve, krahasuar me rezultatin financiar të Komisionit, prej -9.770.698 lekësh.

116. Lidhur me shkakun e ankimit për konkluzion të padrejtë të Komisionit, sipas të cilit dokumentacioni i depozituar në lidhje me financimin e bursës së përfituar nga vajza e subjektit të rivlerësimit për shkollim në {***} në vitet 2014-2017, në vlerën e 181.478 USD, si dhe bursës për shkollim në {***} Mostar në vitet 2012-2014, në vlerën prej 30.000 eurosh, është i paplotë, duke qenë se, sipas subjektit të rivlerësimit, në bursat e akorduara përfshihen edhe shpenzimet për ushqim dhe akomodim dhe ky fakt mund të provohej lehtësisht me një shkresë drejtuar këtyre institucioneve arsimore, trupi gjykues konstatoi fillimisht se, referuar parashikimeve të legjislacionit të zbatueshëm lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar, barrën e provës për të provuar të kundërtën e gjetjeve të rezultuara nga hetimi i kryer nga Komisioni, e ka subjekti i rivlerësimit. Për rrjedhojë, mosangazhimi i Komisionit në komunikim të drejtpërdrejtë me institucionet arsimore pranë të cilave është shkolluar vajza e subjektit të rivlerësimit, nuk mund të përbëjë justifikim për mospërbushje prej këtij të fundit, të barrës së provës në drejtim të gjetjeve të Komisionit dhe, për rrjedhojë, as shkak për kundërshtimin si të padrejtë të konkluzionit të arritur nga ana e Komisionit.
117. Për më tepër, trupi gjykues konstatoi se edhe në ankimin e paraqitur në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur asnjë argument dhe nuk ka paraqitur asnjë provë në drejtim të sa më sipër pretenduar për konkluzion të padrejtë të Komisionit, në vlerësimin e bursave të përfituara nga ana e vajzës së tij. Nga kontrolli i ushtruar vendimmarrjes së Komisionit lidhur me këtë çështje, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
118. Sa i takon vlerësimin të bursës së përfituar nga ana e vajzës së subjektit për shkollimin e saj në Kolegjin {***} në Mostar, Bosnje Hercegovinë, në periudhën gusht 2012 - qershor 2014, si dhe vlerës së detyruar për t’u përmbushur nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij si kontribut prindëror në mbulimin e shpenzimeve të shkollimit, referojuni analizës së kryer në paragrafët 74 e vijues, më sipër në këtë vendim.
119. Ndërkohë, lidhur me shkollimin e znj. A. H. në {***}, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vitet 2014 - 2017, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, në vlerësimin dhe kontrollin e kryer lidhur me çështjen e shkollimit të vajzës së subjektit të rivlerësimit, ka pranuar në cilësinë e provës vërtetimet e përcjella nga {***}, në lidhje me deklaratat e ndihmës financiare të akorduara për vitet shkollore 2014 - 2015, 2015 - 2016, 2016 – 2017, si dhe 2017 - 2018. Bazuar në vërtetimet e lëshuara nga {***}, më datë 02.02.2020, vihet re se konfirmohen deklaratat e ndihmës financiare për vitet e referuara shkollore në lidhje me pagesat për shkollimin sipas përmbajtjes së tyre, në të cilat referohet, ndër të tjera, se kontributi prindëror në mbulimin e tarifave të shkollimit, është
-
- katësh në vitin 2001; 708.371 lekë, kostoja e ndërtimit të objektit 3-katësh në vitin 2003; dhe 708.371 lekë, kostoja e ndërtimit të objektit 3-katësh në vitin 2004.
- Shpenzimet për shlyerje kredie pranë Intesa SanPaolo Bank, u përlllogaritën në vlerë më të ulët se përlllogaritjet e kryera nga Komisioni për vitin 2004, referuar pagesave të kryera sipas lëvizjeve përkatëse bankare.
 - Në analizën financiare të vitit 2004, u përlllogarit shuma e shpenzuar, prej 1.500.000 lekësh, për blerjen e truallit të deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2004, referuar konkluzionit të arritur nga trupi gjykues më sipër në këtë vendim.

përcaktuar në vlerën e 5.000 \$. Ndonëse konstatohet se në të vërtetë, këto vërtetime nuk krijojnë qartësi nëse vlerat totale, sipas çdo viti shkollimi, mbulojnë vetëm pagesat për shkollim apo përfshijnë dhe shpenzime akomodimi, ushqimi, veshmbathjeje etj., ajo çka vlen të shënohet dhe ndikon analizën e trupit gjykues në lidhje me vlerësimin e këtij shkaku ankimi, është fakti se referuar sa më sipër, kontributi prindëror vlerësohet të ketë qenë minimalisht në vlerën e 5.000 USD, për çdo vit shkollor. Ky kontribut rezultoi të jetë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit edhe në pyetësonin standard, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni nëse ka kryer transaksione financiare bankare, me vlerë mbi 200.000 lekë, nga data 01.01.2017 deri në ditën e marrjes së pyetësorit, është përgjigjur ndër të tjera: *Kontribut prindëror për arsimimin e vajzës A. H. në {***}, USA, në shumën 5000 (pesë mijë) USD, për vitin shkollor 2017-2018, të cilat janë depozituar pranë {***}, USA, nga vajza ime A. H.*

120. Gjithashtu, në të njëjtin pyetësor, i pyetur nga Komisioni për shpenzime që e tejkalojnë shumën 2.500 euro në shtatë vitet e fundit, subjekti është përgjigjur: *Po, familjarisht kemi bërë shpenzime që e tejkalojnë shumën prej 2.500 eurosh në shtatë vitet e fundit. Qëllimi i këtyre shpenzimeve ka qenë kontributi familjar/prindëror për shkollimin e vajzës A. H. si më poshtë: [...] – dhe në vijim ka deklaruar për çdo vit shkollor të periudhës 2014 -2018, vlerën prej 5.000 \$, si shpenzim të kryer në formën e kontributit prindëror vjetor për shkollimin e vajzës së tij A. H. në {***}, ShBA.*
121. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar konkluzionin e Komisionit për përlllogaritjen e vlerës së kontributit prindëror si shpenzim shkollimi në analizat financiare të viteve përkatëse.
122. *Lidhur me konkluzionin e Komisionit mbi çështjen e shpenzimeve të vajzës së subjektit të rivlerësimit për shkollën verore në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2012, subjekti shprehet se ky shpenzim nuk është deklaruar prej tij në deklaratën periodike dhe as në deklaratën e pasurisë “vetting”, për shkak se këto shpenzime janë përballuar nga ana e tij dhe e bashkëshortes së tij dhe se të paguara veç e veç nuk e kalonin limitin e 300.000 lekëve për deklaram. Subjekti sqaroi se edhe në pyetësorë nuk e ka deklaruar vlerën e plotë pasi nuk e dispononte dokumentacionin e saktë.*
123. Trupi gjykues konstatoi se këto pretendime janë ngritur përpara Komisionit që në fazën e shpjegimeve ndaj rezultateve të hetimit dhe për këto pretendime, Komisioni është shprehur në vendim duke argumentuar, ndër të tjera, si vijon: *Subjekti pretendoi se këto shpenzime nuk janë deklaruar në deklaratën periodike vjetore, sepse janë bërë përmes pagesave të veçanta gjatë vitit dhe asnjë prej tyre nuk e kalonte vlerën 300.000 lekë. Ndërkohë, sipas provës dokumentare që ka sjellë subjekti, rezultoi se transferta bankare e bërë për këtë universitet nga bashkëshortja është bërë me një pagesë të vetme prej 3,300 GBP, datë 29.5.2012. Te përshkrimi i transfertës, duket qartë se pagesa mbulon vetëm vlerën e studimeve. Pra, rezultoi se subjekti nuk ka qenë i saktë në deklaramet për këto shpenzime. Subjekti nuk ka dhënë shpjegime lidhur me shpenzimet e tjera të vajzës gjatë periudhës së studimeve në Mbretërinë e Bashkuar.*
124. Nga verifikimi i kryer në aktet e fashikullit të çështjes, trupi gjykues konstatoi se sa më sipër referuar nga Komisioni, përputhet me faktet e provuara sipas akteve të fashikullit dhe, për rrjedhojë, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi lidhur me shpenzimet e deklarueshme, e gjen të drejtë dhe të bazuar konkluzionin përfundimtar të Komisionit se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën periodike të vitit 2012. Referuar kuptimit të dhënë në nenin 2, pika 7 e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar me ligjin nr. 85/2012, “shpenzimi i deklarueshëm” është tërësia monetare e paguar për arsim, mjekim, pushime, arredim, si dhe të tjera shpenzime të

këtij lloji. Në këtë kuptim, edhe në eventualitetin që pagesat do të ishin kryer në formë pjesore, sikundër pretenduar nga ana e subjektit të rivlerësimit, për sa kohë totali i tyre arrin vlerën e përcaktuar me ligj si shpenzim të deklarueshëm, mosdeklarimi nga ana e subjektit të rivlerësimit do ta vendoste atë në kushtet e deklarimit të pasaktë të deklarates periodike përkatëse. Në çdo rast, trupi gjykues thekson se për nevojat e procesit të rivlerësimit, efektet e kësaj pasaktësie në deklarimin periodik, shtrihen në këtë rast vetëm në rezultatin e analizës financiare të vitit në të cilin ka ndodhur ky shpenzim.

125. *Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit automjet, të tipit “Mercedes Benz”, të blerë në vitin 2012, në vlerën e 200.000 lekëve dhe shitur në vijim vëllait të subjektit të rivlerësimit në vlerën e 500.000 lekëve, për të cilën subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar rezultatin e analizës financiare të Komisionit për pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për krijimin e saj, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
126. Në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni është shprehur në vendim si vijon: *Komisioni, lidhur me këtë pasuri, arriti në përfundimin se:*
- *Subjekti pretendoi se shpenzimet e mirëmbajtjes të bëra për automjetin, duhet të ishin shpërndarë në vitet pas blerjes deri në shitjen e tij. Por ky qëndrim nuk përkon me qëndrimin e mbajtur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit, ku pretendoi se automjetin ia ka shitur pa letra të vëllait, menjëherë, pasi i ka plotësuar dokumentacionin dhe pas një shërbimi të bërë.*
 - *Subjekti nuk vërtetoi me dokumentacion të ardhurat e pretenduara të bashkëshortes nga punëdhënësi, F. Sh. F. dhe këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizën financiare.*
 - *Ky automjet nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të dorëzuar në ILDKPKI për vitin 2012, dhe as nuk provoi se burimi për blerjen e kësaj pasurie është nga gjendje “cash” e krijuar për atë vit. Saktësojmë se edhe në deklaratat periodike vjetore, subjekti nuk ka deklaruar ndryshim të gjendjes “cash” (shtesa dhe pakësime).*
 - *Subjekti ka bërë deklarim të pasaktë dhe është në pamundësi financiare dhe burimi të ligjshëm për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2012, në vlerën prej -260.560 lekësh.*
127. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me vlerësimin e kësaj pasurie, kundërshtoi analizën e kryer nga Komisioni mbi verifikimin e burimeve të ligjshme për krijimin e këtij automjeti, në drejtim të mosmarrjes në konsideratë të gjendjes *cash* të vitit paraardhës, të të ardhurave të bashkëshortes së tij nga angazhimi në F. Sh. F., si dhe të faktit se shpenzimet për automjetin, sipas tij, janë kryer deri në datën e shitjes së automjetit dhe jo në momentin e blerjes së tij, sikundër i ka përlogaritur Komisioni.
128. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, në lidhje me pretendimin e subjektit se për blerjen e automjetit, ai ka përdorur gjendjen e akumuluar të *cash*-it të ndodhur në banesë nga viti i mëparshëm, trupi gjykues konstatoi se nga aktet e administruara nga hetimi administrativ në Komision, nuk ka asnjë të dhënë e cila të përbëjë indicie në drejtim të sa më sipër. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit në drejtim të mosvlerësimit të gjendjes së akumuluar të *cash*-it në banesë, si burim për blerjen e kësaj pasurie, gjendet i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe në përputhje dhe me standardin e ndjekur nga Kolegji në vendimmarrje të mëparshme, sipas të cilit, në kushtet kur

përdorimi i likuiditeteve në gjendje *cash* në banesë, nuk është deklaruar as si burim për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, as si pakësim i gjendjes së këtij likuiditeti në datën 31 dhjetor të vitit të deklarimit në të cilin është krijuar pasuria, ai nuk mund të konsiderohet si burim i ligjshëm për krijimin e pasurive të subjekteve të rivlerësimit.

129. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit në lidhje me shpenzimet e kryera për automjetin, duke i pretenduar ato si të shtrira në kohë deri në momentin e shitjes së automjetit, trupi gjykues konstatoi se Komisioni ka argumentuar konkluzionin e tij duke e gjetur këtë pretendim të subjektit në kundërshtim me vetë qëndrimin e mbajtur prej tij në përgjigje të pyetësorit të Komisionit, ku ka pretenduar se *automjetin ia ka shitur pa letra të vëllait, menjëherë, pasi i ka plotësuar dokumentacionin dhe pas një shërbimi të bërë*. Trupi gjykues, lidhur me sa më sipër, konstatoi se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit, përveçse bie në kundërshtim të hapur me qëndrime të mëparshme të tij para Komisionit, mbeti në nivel deklarativ, pasi nuk u arrit të provohet prej tij.
130. Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit për mospërfshirjen në analizë të të ardhurave të bashkëshortes nga angazhimi pranë F. K. F., trupi gjykues i gjeti ato të drejta e të bazuara³⁶, për rrjedhojë efekti i tyre u pasqyrua në analizën financiare të Komisionit lidhur me krijimin në vitin 2012 të pasurisë objekt kontrolli, në zërin “Të ardhura nga punësimi A. S.”, duke e rritur atë përkatësisht. Nga kontrolli i kryer nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, në drejtim të saktësisë së përlllogaritjeve të Komisionit, sipas zërave përkatës, trupi gjykues konstatoi se për pasurinë e luajtshme të llojit “automjet”, të tipit “Mercedes Benz”, të blerë në vitin 2012, në vlerën e 200.000 lekëve, subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së tij, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
131. Sa i takon çështjes së të ardhurave të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga marrëdhëniet e punës sipas deklarimit në deklaratën e pasurisë “vetting”, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit për mosmarrjen në konsideratë të këtyre të ardhurave sipas vërtetimeve të punëdhënësve, si qëndrim me dy standarde dhe cenim të parimit të barazisë, duke qenë se në raste të tjera, për të tjera subjekte rivlerësimi, Komisioni³⁷ ka mbajtur qëndrim të ndryshëm.
132. Në shqyrtimin e këtij shkak ankimi, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se në raste të tjera Komisioni ndryshe nga çka vlerësuar në çështjen objekt gjykimi, i ka marrë në konsideratë të ardhurat sipas deklarimeve, nuk mund të përbëjë *a priori* shkak për të konsideruar të padrejtë apo të pavlefshëm vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e situatës faktike të provuar nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, në kuadër të shkaqeve të ngritura në ankim dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Një qëndrim i tillë i Kolegjit është tashmë i konsoliduar me vendimmarrje të mëparshme të tij. Për rrjedhojë të sa më sipër, në vijim edhe të analizës së këtyre

³⁶ Referojuni analizës së kryer në paragrafët 74 e vijues në këtë vendim.

³⁷ Subjekti referoi qëndrimin e Komisionit në vendimin nr. 103, datë, 05.02.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. D. P. dhe në vendimin nr. 169, datë 26.06.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. R. P..

të ardhurave referuar kundërshtimeve të subjektit të rivlerësimit të artikuluar në drejtim të shkaqeve të ngritura për kundërshtimin e konkluzioneve të Komisionit lidhur me pasuritë e marra më sipër në analizë, për të cilat të ardhurat e bashkëshortes janë pretenduar si burim krijimi, si dhe verifikimit të përlogaritjeve të kryera nga Komisioni lidhur me këtë zë të ardhurash, u arrit në përfundimin se konkluzionet e Komisionit mbeten të pandryshuara, përveç sa analizuar më sipër në këtë vendim³⁸ lidhur me të ardhurat e znj. A. S. pranë F. K. F..

133. Sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit se bashkëshortja e tij është zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë si anëtare zëvendësuese pranë Komisionerëve Publikë dhe, për rrjedhojë, i është nënshtruar vlerësimit të pasurisë nga ku, sipas subjektit të rivlerësimit, këto të ardhura janë vlerësuar si të ligjshme, trupi gjykues çmon se ky është një pretendim i pabazuar. Verifikimi i kryer në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, sa i takon bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, u nënshtrohet rregullave dhe procedurave të zbatueshme për personat të cilët vlerësohen sipas ligjit si persona të lidhur me subjektin e rivlerësimit. Në këto kushte, çdo vlerësim tjetër i pasurisë së këtyre personave, i kryer në kuadër të procedurave/proceseve të tjera të cilat janë jashtë objektit të kontrollit të ushtruar sipas legjislacionit të zbatueshëm për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk parashikohet të sjellë pasoja juridike në rezultatet e kontrollit të ushtruar nga institucionet e rivlerësimit. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se për sa kohë znj. A. S. rezultoi që gjatë procedurës së rivlerësimit të subjektit Skënder Haluci ka pasur statusin e personit të lidhur me një subjekt rivlerësimi, detyrimisht duhej t'i nënshtrohej procedurës së kontrollit dhe vlerësimit të pasurisë së saj, sipas parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës, dispozitave të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, edhe të ardhurat e krijuara prej saj do t'i nënshtroheshin verifikimit sipas standardit të të ardhurave të ligjshme, në përputhje me parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
134. *Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se analiza financiare e kryer nga Komisioni për gjithë periudhën e vlerësimit, është arbitrare, pasi, sipas tij, kostoja reale e tokës dhe e banesës së ndërtuar në të, nga 3.400.000 lekë, është llogaritur nga Komisioni në 20.875.706 lekë banesa dhe 37.945.600 lekë toka, gjithsej mbi 58.000.000, sikundër dhe i janë llogaritur si shpenzime të tij edhe shlyerja e kredisë në vlerën e 34.965 USD, e kryer nga z. F. V., si dhe nuk i janë marrë në konsideratë të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga marrëdhëniet e saj të punësimit, të cilat kapin vlerën e mbi 20.000.000 lekëve, trupit gjykues, në vijim të konkluzioneve të arritura më sipër në këtë vendim, lidhur me çështjet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit, pasi reflektoi këto konkluzione në zërat e analizës së Komisionit të kryer për periudhën e vlerësimit 1997 - 2016, mbi bazën e shkaqeve të ankimit, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të i rezultuan me mungesë të të ardhurave të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera gjatë kësaj periudhe, në vlerën totale prej 27.992.277 lekësh.*
135. Në këto kushte, trupi gjykues, në vijim të konkluzioneve të mësipërme, bazuar në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 33, pika 5, germet “a” dhe “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vlerësoi se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, për rrjedhojë, duhet të lihet në fuqi.

³⁸ Referoju konkluzionit lidhur me trajtimin e të ardhurave të siguruara nga angazhimi i znj. A. S. pranë F. K. F., shih paragrafin 77 e vijues, më sipër në këtë vendim.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 244, datë 05.03.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Skënder Haluci.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 27.10.2022, në Tiranë.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi